

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7597 E diel 22 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Më 30 qershor, disa autoritete europiane penguan një sulm ndaj tubimit të përvitshëm 'Irani i Lirë' të organizuar nga mbështetësit të Këshillit ...
Vijon në faqen 21

Nga KEN BLACKWELL

Prapaskenat e një komploti të parandaluar terrorist




Opinion **i** Ditës

Po dilja nga gjykata mesditën e së enjtes, kur një lajm i befte me tronditi jo veç mua. Një koleg i nderuar ishte rrahur barbarisht pranë gjykatës së Durrësit...
Vijon në faqen 22

Nga DENISA DAKA

Heshtja i vret të gjithë...



Televizioni "ZDF": Intervistë në "atelie"

Rrëfimi i Edi Ramës: Ja pse vizatoj në zyrë. Refugjatët? Do bëjmë pjesën tonë

Media gjermane: Me vizion, artist i pasionit.
Rama: Europën e duam se kemi parë luftën

Kryeministri Edi Rama deklaroi në një intervistë për televizionin publik gjerman, "ZDF", se "ne jetojmë në një situatë që përsëri përkufizohet nga "mallkimi i Ballkanit". Kur ne ishim në formën më të keqe, Europa ishte në formën e saj më të mirë. Tani që ne jemi në formë të mirë, nuk është Europa mirë". Duke iu përgjigjur pyetjes ...
Në faqen 3

EMRAT/ BASHKIA PUBLIKON LISTEN E ASISTENCES NE KRYEQYTET

NDIHMJA EKONOMIKE, 3200 PERFITUESIT NE TIRANE

Këshilli bashkiak përgatitet të miratojë pagesat e korrikut. E marrin invalidët, jetimët, viktimat e trafikimit e dhunës dhe prindërit me shumë fëmijë



(Në foto) Bashkia Tiranë

Në faqet 8-12

"PO FSHIHEN PERGJIMET"

Basha: Drejtësia e kapur po mbron Dakon, Tahirin dhe Gjijnurin

Në faqen 4

RAHJA NE DURRES

Babai i autorit që dhunoi avokatin: Faji i prokurorit, keqardhje për aktin

Në faqen 7

SHQIPERI-GREQI

"Deti", Kotzias akuzon opozitat në dy vendet: Ka negativitet

Në faqen 2

PROJEKTI

KE-ja i drejton 15 pyetje qeverisë për prishjen e Teatrit Kombëtar

Në faqen 5

PERPLASJA



Kryetari i PD në Gramsh shan policët në rrugë, nis procedimi penal

Në faqen 6

MIXO Vepra e Herodotit për orakullin e Dodonës dhe banorëve rreth saj

Akili i falej Zeusit pellazgjik të Dodonës

Në brendësi: Aristotel Mici, Rexhep Ferri, Arqile Teta, Vahid Hyzoti

Nga ARISTOTEL MICI

Në veprën e tij monumentale "Historitë" Herodoti na përshkruan mjaftë hollësisht rreth Orakullit të Dodonës dhe banorëve për rreth saj. Historiani më i vjetër i botës aty na njeh edhe me pellazgët, duke i



konsideruar ata jo vetëm si më të herëshëm se helenët, po edhe që kanë ndihmuar në formimin e tyre kulturor dhe shpirtëror, krahas ndikimit egjiptian. Me fjalët e tij Herodoti do të përforcojë idenë se jo të gjitha zakonet Helenët i kanë marrë prej ...
Suplement

PAKTI ME GREQINË REAGIMI

Ministri i Jashtëm grek: Duam të jetojmë në paqe me fqinjët

Pakti detar, Kotzias: Opozitat e dy vendeve po krijojnë stereotipe negative

"Duhet pjekuri në zgjidhjen e çështjeve me Shqipërinë"

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, ka shprehur shpresën që opinioni publik dhe politik në vend të tregojë më shumë pjekuri lidhur me negociatat që po zhvillohen Athina me Tiranën. "Besoj se populli ynë po mësohet dalëngadalë të mbështesë zgjidhjet dhe jo problemet. Rrjedhimisht kam shpresën që të ketë një pjekuri më të madhe ndaj zgjidhjes së problemeve që kemi me Shqipërinë", u shpreh Kotzias.

"Ne duam miqësi ndërmjet popujve dhe një politikë bashkëjetese paqësore ndërmjet shoqërive tona. Personalisht gjithmonë mburrem me studentët e mi shqiptarë në Universitetin e Pireut që tashmë janë bërë pedagogë në vendin e tyre", nënvizon Kotzias në një intervistë për të përditshmen greke "Efimerida ton Sintakton". Ministri i Jashtëm grek ka vënë në dukje se problemet me Shqipërinë datojnë madje që prej 90 vjetësh. "Ne kemi probleme me Shqipërinë, madje edhe 90 vjeçare. Çështjet mbeten të pazgjidhura pasi u ekspozuan në një masë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, shtuar këtu faktin që qeveritë e mëparshme, edhe nëse donin të zgjidhnin disa prej tyre, i lanë në mes të rrugës. Le të marrim si shembull ligjin e luftës. Opozitat, në të dy anët e kufirit, po përpigën të punojë mbi këtë bazë, mbi zemërimin e njerëzve. Për të riprodhuar stereotipet negative dhe paragjykimet mes popujve. Arritën të thonë se Greqia humbi Epirin e Veriut për shkakun tim", u shpreh Kotzias. Sa i përket marrëveshjes Athinë-Shkup dhe hartës rrugore për implementimin e saj, Kotzias ka thënë se pala greke pret që qeveria në Maqedoni të fitojë referendumin dhe votimin për ndryshimin e Kushtetutës. "Ne do të vazhdojmë përpjekjet për të siguruar një maxhorancë në favor të marrëveshjes kur të votohet në parlamentin grek", u shpreh ai. "Duam që bashkërisht të përballojmë retorikën e urrejtjes, sepse duam të jetojmë në paqe me popullin e vendit fqinj", ka përfunduar Kotzias.



Ministri i Jashtëm i Greqisë Nikos Kotzias

Pak ditë më parë, ndërsa ka qenë në një seancë dëgjimore në Komisionin e Jashtëm në Kuvend, ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati ka thënë se nuk ka marrëveshje për ndryshim kufijsh, por për një proces teknik për mirëmbajtjen e piramidave tokësore. Duke iu përgjigjur akuzave edhe të opozitës, Bushati tha: "Po diskutojmë me palën greke. Opinioni publik është informuar. Kemi një marrëveshje në dis-

kutim dhe 2 projektmar-rëveshje një për piramidat dhe një për menaxhimin. Është një komunikim institucional, kemi shkuar përtej detyrimeve që cakton ligji. E kam thënë që s'ka arsye për protagonizëm. Jemi pjesë e një ekipi". "Ka shumë dezinformim sidomos nga PD. Flitet për km katrorë det, për zona potencialisht naf-tëmbajtëse, për fshirje të no-cionit të çështjes came, është e qartë që ka një tentativë të

DITMIR BUSHATI
"Ka shumë dezinformim sidomos nga PD. Flitet për km katrorë det, për zona potencialisht naf-tëmbajtëse, për fshirje të no-cionit të çështjes came, është e qartë që ka një tentativë të orkestruar për ta mbajtur këtë marrëdhënie në tension. Jemi të vendosur për ta mbajtur këtë deri në një", - tha Bushati.

orkestruar për ta mbajtur këtë marrëdhënie në tension. Jemi të vendosur për ta mbajtur këtë deri në një. Kemi një plus në raport me Greqinë, kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese që na thotë qartë çfarë s'duhet të bëjmë. I kemi qëndruar konform këtij vendimi. S'duhet ta ushqejmë opinionin publik me iluzione. Greqia s'ka humbur asnjë luftë me ne, as ne me ata", u shpreh Bushati.



Edi Rama në takim me Alexis Tsipras në Londër

Dokumentet e Ministrisë së Jashtme

Përpjekjet e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Lidhjen e Kombeve që të ruante kufijtë

Në "Historinë e diplomacisë shqiptare", në arkivat e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, gjenden online dhe dokumentet e përpjekjeve të Shqipërisë për anëtarësimin në Lidhjen e Kombeve, në vitin 1920. Anëtarësia në organizatën e Lidhjes së Kombeve shënon fillimet e diplomacisë shumëpalëshe për shtetin shqiptar. Delegacioni shqiptar mbajti gjithmonë një qëndrim aktiv dhe progresist në këtë organizatë, e kryesisht në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve kudo ku ato ndodheshin.



Qeveria shqiptare e konsideroi anëtarësimin në këtë organizatë si garanci për një trajtim më të drejtë të statusit dhe kufijve të Shqipërisë në tryezat vendimarrëse të Fuqive të Mëdha. Ajo shfrytëzoi faktin që më 15 nëntor 1920 do të hapet sesioni i parë i Asamblesë së Lidhjes së Kombeve në Gjenevë të Zvicrës. Më 12 tetor, kryetari i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes, Pandeli Evangjeli, i drejtoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve Eric Drummond, në të cilën në emër të popullit shqiptar i kërkoi që Shqipëria të pranohet anëtare në Lidhjen e Kombeve, dhe të merrte pjesë në Asamblesë e madhe që do të hapet më 15 nëntor. Periudha 12 tetor 1920 deri më 17 dhjetor 1920, kur Shqipëria u pranua si anëtare me të drejta të plota në Lidhjen e Kombeve, ishte e mbushur me një punë intensive diplomatike të qeverisë shqiptare dhe delegacioneve të saj në Paris e Gjenevë, dhe e mbështetur nga miq të Shqipërisë dhe shqiptarëve, ku spikati deputeti britanik Aubrey Herbert, etj.

Shqipëri-Kosovë, protokoll bashkëpunimi për sezonin veror

Xhafaj-Gashi: Intensifikim i punës për zvogëlimin e rrezikut nga terrorizmi

Ministri i Brendshëm Ditmir Xhafaj prit dje, ministrin e Punëve të Brendshme të Kosovës, Bejtush Gashi. Dy ministrat kanë nënshkruar një protokoll bashkëpunimi për sezonin turistik veror. Protokollin ka qëllim intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve për të forcur bashkëpunimin midis policive të dy vendeve, nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të përbashkëta në fushën e kontrollit kufitar. Pas takimit ministri Xhafaj tha se "besoj fort se midis dy ministrive dhe dy policive tona, do të vazhdojë të ketë një bashkëpunim më intensiv në interes të



popujve tanë, në interes të të gjithë shqiptarëve, në interes të sigurisë së vendeve tona, të rendit, qetësisë që iu ofrojmë njerëzve tanë, në dy anët e kufirit. Por besoj fort, edhe në interes së sigurisë rajonale është një kontribut i çmuar bashkëpunimi ndërmjet policisë së Kosovës dhe policisë shqiptare dhe forcave respektive të sigurisë". Xhafaj bëri të di-

tur se homologu Kosovar ngri-ti shqetësimin e sigurisë rrugore të shtetasve që vijnë nga Kosova. Ndërkohë e njo-hu edhe me amendimin në Kodin Rrugor që u krijon lehtësi këtyre shtetasve për marrjen e patentave. Nga ana e tij, ministri kosovar, Gashi tha se kishin diskutuar për parandalimin e rreziqeve dhe fenomenit me theks të veçantë të terrorizmit dhe krimit të organizuar. "Për parandalimin e këtyre fenomeneve, ne si dy shtete, kemi një bashkëpunim, i cili duhet intensifikuar dhe të reagojmë në kohë dhe të ndikojmë që këto fenomene të zvogëlohen", tha Gashi.



Televizioni gjerman, "ZDF": Edi Rama lider me vizion, artist i pasionit dhe suksesit

Refugjatët, Rama: Do bëjmë pjesën tonë, Europa është për të ndarë përgjegjësitë

"Shqipëria, vendi ku njerëzit në rrezik gjithmonë gjejnë strehë"

Kryeministri Edi Rama deklaroi në një intervistë për televizionin publik gjerman, "ZDF", se "ne jetojmë në një situatë që përsëri përkufizohet nga "mallkimi i Ballkanit". Kur ne ishim në formën më të keqe, Europa ishte në formën e saj më të mirë. Tani që ne jemi në formë të mirë, nuk është Europa mirë". Duke iu përgjigjur pyetjes lidhur me integrimin, Rama shtoi se "në mes të kësaj sinergie, ne vazhdojmë të përqijemi dhe të punojmë. Ne kemi bërë shumë progres. Tani ne kemi edhe një afat për hapjen e negociatave vitin e ardhshëm. Dhe ne na duket të përqijemi dhe ta arrijmë. Dhe më pas të vazhdojmë e të vazhdojmë. Kjo është diçka që bëhet gjithnjë e më e madhe". I pyetur lidhur me krizën aktuale të refugjatëve, Rama shprehet se "ne nuk do të jemi asnjëherë pjesë e ndonjë plani ku refugjatët do të trajtohen si njerëz të infektuar". Nga ana tjetër, ne jemi të gatshëm të bëjmë pjesën tonë. Nuk mendoj se Europa është vetëm për të ndarë përfitimet nga buxheti. Por, Europa është edhe për të ndarë përgjegjësitë. Ne nuk jemi në Bashkimin Europian, por duhet të jemi të gatshëm të marrim pjesën tonë. As më shumë dhe as më pak", deklaroi kryeministri.



Kryeministri Edi Rama

ANËTARËSIMI
"Ne jetojmë në një situatë që përsëri përkufizohet nga "mallkimi i Ballkanit". Kur ne ishim në formën më të keqe, Europa ishte në formën e saj më të mirë. Tani që ne jemi në formë të mirë, nuk është Europa mirë. Pra, në mes të kësaj sinergie, ne vazhdojmë të përqijemi dhe të punojmë",-u shpreh kryeministri.

PROGRESI

Kryeministri Rama tha se Shqipëria ka bërë progres. "Tani ne kemi edhe një afat për hapjen e negociatave vitin e ardhshëm. Dhe ne na duket të përqijemi dhe ta arrijmë. Dhe më pas të vazhdojmë e të vazhdojmë. Kjo është diçka që bëhet gjithnjë e më e madhe",-tha ai.

REFUGJATËT

"Në ditët e sotme ne kemi mirëpritur disa qindra refugjatë nga Irani, refugjatë politikë. Pra, ne jemi vend që ofrojmë strehë. Ne jemi, gjithashtu, një vend që përfiton nga mikpritja në Gjermani, në Itali dhe Greqi, në Europë dhe Amerikë. Pra, shqiptarët asnjëherë nuk i kanë konsideruar refugjatët si rrezik apo si diçka që duhet shmangur",-tha Rama.

VIZATIMI

"Më ndihmon të përqijem. Më ndihmon të ul tensionin gjatë procesit të ndërveprimit dhe, gjithashtu, më ndihmon të komunikoj më së më të ulët dhe kjo është një gjë e mirë. Ndodh ndonjëherë, për shkak se tensioni është i lartë, ndodh që njeriu kërkon mënyrë të tjera komunikimi,-tregoi Rama.

bashkëbiseduesit tuaj?
Bashkëpunëtorët e mi e dinë dhe shqetësohen me shumë kur unë nuk jam duke vizatuar. Por, kur njerëzit vijnë të më takojnë ndonjëherë mund të jetë e vështirë. Po ju tregoj një rast. Erdhi dikush të më takojë. Ai u ul tamam aty ku po qëndroni edhe ju. Ai filloi të më tregojë diçka ndërsa unë po vizatoja. Ai më tha: Më falni, ose më dëgjo mua ose unë po iki dhe ju vazhdoni të vizatoni. Unë ju përgjigja: Në rregull. Dhe unë e lashë vizatimin. Pas një çasti ai më pyeti: A po më dëgjon? Dhe unë ju përgjigja: Jo, sepse në qoftë se nuk vizatoj nuk përqendrohem dot në bisedë të drejtëpërdrejtë. Pra, me mua funksionin pak a shumë kështu.

Një nga aktet e para si kryetar i Bashkisë së Tiranës ishte të ndryshojë fasadat e ndërtesave të hirta. Cila ishte arsyeja këtij projekti të madh urban?
Filloi si një nevojë. Kur u zgjodha me një shumicë të madhe, pritshmëritë ishin shumë të mëdha. Buxheti i qytetit ishte i papërfillshëm. Më duhej të filloja nga diku dhe me diçka. Dhe kështu më erdhi ideja ta filloja duke lyer ndërtesat për të hequr atë ngjyrë të hirtë shqetësuese që të shkurajonin. Dhe më pas vazhdoi efekti

“ Singjerisht mendoj se në këtë periudhë Europa kishte fatin të kishte Angelan Merkelin. Po të mos ishte ajo, nuk di kush mund ta shpëtonte nderin e Europës. Pra, ky është mendimi im.

domino në shumë gjëra të tjera. Qyteti u bë shumë më miqësor dhe, gjithashtu, njerëzit filluan të ndjejnë qytetin që humbën gjatë tranzicionit të trazuar të viteve 90-të. Kështu, bukuria është një instrument kundër shumë sëmundjesh të shoqërisë dhe hapësirat e bukura publike krijojnë energji që më pas sjell kurajo dhe frymëzim për të investuar në dyqanin e vogël, për ta shndërruar në diçka më tërheqëse, për të investuar në diçka tjetër. Prandaj, unë besoj fort se bukuria mund të bëjë atë që nuk mund ta bëjnë mijëra policë edhe ndaj kriminalitetit apo sjelljes së keqe në vend publik. Aty ku ka shëmti, nuk ka shpresë. Aty ku ka bukuri, ka shpresë. Natyrisht, ka ende sfida.

Si e keni përjetuar ju në Ballkan krizën aktuale në

Europë? Dhe sa mbështeteni në shpresat për të hyrë së shpejti në BE?

Ne jetojmë në një situatë që përsëri përkufizohet nga "mallkimi i Ballkanit". Kur ne ishim në formën më të keqe, Europa ishte në formën e saj më të mirë. Tani që ne jemi në formë të mirë, nuk është Europa mirë. Pra, në mes të kësaj sinergie, ne vazhdojmë të përqijemi dhe të punojmë. Ne kemi bërë shumë progres. Tani ne kemi edhe një afat për hapjen e negociatave vitin e ardhshëm. Dhe ne na duket të përqijemi dhe ta arrijmë. Dhe më pas të vazhdojmë e të vazhdojmë. Kjo është diçka që bëhet gjithnjë e më e madhe.

Si po ecin punët me Europën?

Dua të jem i singjertë me ju. Nuk jam diplomat i mirë. Së pari, mendoj se mund të bëhet më keq përpara se të bëhet më mirë. Është diçka e lidhur me faktin se Europa sot dominohet nga brezi i parë që nuk njohu luftën. Dhe duke mos njohur luftën, ata nuk e kuptojnë plotësisht thelbin e asaj çfarë është Bashkimi Europian. Më kujtohet gjithmonë Helmut Kohli kur foli për bashkimin monetar. Përpara se të jetë diçka që ka të bëjë me financën, është diçka që ka të bëjë me vëllain tim, i cili humbi jetën në luftë. Ne e kemi më të lehtë. Ne mund të dukemi naivë në Ballkan, sepse ne jemi shumë pro-europianë, por ne kemi parë luftën. Dhe lufta për ne nuk ishte diçka në televizion, por diçka e vërtetë. Te ne erdhen më shumë se gjysmë milioni refugjatë nga Kosova, të cilët po ikin nga lufta. Dhe nga

ana tjetër, singjerisht mendoj se në këtë periudhë Europa kishte fatin të kishte Angelan Merkelin. Po të mos ishte ajo, nuk di kush mund ta shpëtonte nderin e Europës. Pra, ky është mendimi im.

Si do të veprojë qeveria juaj në krizën aktuale të refugjatëve?

Ne nuk do të jemi asnjëherë pjesë e ndonjë plani ku refugjatët do të trajtohen si njerëz të infektuar. Nga ana tjetër, ne jemi të gatshëm të bëjmë pjesën tonë. Nuk mendoj se Europa është vetëm për të ndarë përfitimet nga buxheti. Por, Europa është edhe për të ndarë përgjegjësitë. Ne nuk jemi në Bashkimin Europian, por duhet të jemi të gatshëm të marrim pjesën tonë. As më shumë dhe as më pak. Ky është nocioni ynë. Shqipëria është vendi ku njerëzit në rrezik gjithmonë gjejnë strehë. Ne jemi i vetmi vend në Europë ku hebrejtë ishin më të shumtë në numër pas luftës se përpara luftës. Asnjë hebre nuk iu dorëzua nazistëve në Shqipëri. Më vonë, kemi pasur më shumë se gjysmë milioni refugjatë nga Kosova. Ne jemi një vend i vogël për gjysmë milioni refugjatë, por ia dolëm më së miri. Në ditët e sotme ne kemi mirëpritur disa qindra refugjatë nga Irani, refugjatë politikë. Pra, ne jemi vend që ofrojmë strehë. Ne jemi, gjithashtu, një vend që përfiton nga mikpritja në Gjermani, në Itali dhe Greqi, në Europë dhe Amerikë. Pra, shqiptarët asnjëherë nuk i kanë konsideruar refugjatët si rrezik apo si diçka që duhet shmangur.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përmbairimorë "Best 2018"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 17 gusht 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përmbairimore do zhvillohet ankand për shitjen e pasurisë nr.58/06, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Truallit që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshjeje sipërmarjeje. Prona është e vëllezërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta. Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 54150000 lek. Çmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor. Ofertuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përmbairimore 10% të çmimit fillestar. Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-222-6000 E-mail: best.2010@permbairues.al, web: www.permbairues.al

SITUATA POLITIKE REAGIMET

Durrës, kreu i PD-së akuzo ndaj kryeministrit: Duhet ta ndalim

Basha: Rama shkatërroi drejtësinë për të mbrojtur Dakon, Tahirin e ministrat

"Beteja për Teatrin është për kthimin e shtetit ligjor"

Darina Tanushi

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha deklaroi dje, nga Durrësi se kryeministri Edi Rama shkatërroi reformën në drejtësi për të mbrojtur Vangjush Dakon, Saimir Tahirin e ministrat e tij. Kreu i opozitës tha se ka ardhur koha që demokratët bashkë me qytetarët të sjellin ndryshimin në Durrës pas shumë vitesh tiranie mafioze të krimit dhe korrupsionit, arsyt kryesore të shkatërrimit të zgjedhjeve të lira. "Është kjo arsyeja që nuk i kërkojmë dot illogarit Gjushit. Se, në fakt, Gjushi, nuk e ka lidhur me ju, e ka lidhur me bandat fatin e tij në politikë. E për këtë arsye në një vend normal, nuk duhet të ishte në Bashki, por duhet të ishte në qeli." - u shpreh Basha. Takimi i Bashës me qytetarët e Durrësit përkoi me dy vjetorin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese për reformën në drejtësi, e cila, siç vuri në dukje Basha, është një reformë e shkatërruar në themel. "Reforma në drejtësi është shkatërruar pikërisht për të mbrojtur Vangjush Dakon, siç mbron kjo drejtësi e kapur, Saimir Tahirin, siç mbron kjo drejtësi e kapur, Arben Ahmetajn, Damian Gjokunurin, dosjet e të cilëve nuk janë gjë tjetër, veçse pastrim i parave të pista të krimit me bashkëpunimin e Edi Ramës dhe bandës së tij qeveritare." - tha Basha. Basha u kërkoi qytetarëve ta shihnin çështjen e Teatrit jo vetëm si një aferë korruptive, por si çështje e lirisë së tyre personale, për sa kohë Edi Rama ka asgjësuar Gjykatën Kushtetuese dhe ka marrë nën kontroll çdo pushtet. "Çështja e Teatrit Kombëtar është beteja për të rikthyer shtetin ligjor, ose fundi i shtetit ligjor, i shtetit të së drejtës dhe fillimi i një diktature të krimit, e cila, atë që po bën me Teatrin, nëse do ta bëjë



Kryetari i PD Lulzim Basha

me pronat tuaja, me shpëtimet tuaja. Kemi arritur aty ku nuk mban më, sepse Edi Rama dhe Vangjush Dako nuk do të ndalen, po nuk i ndalëm ne". U shpreh kryetari i PD. Basha tha se Shqipërisë i duhet një qeveri ku kryeministri dhe ministri i Brendshëm të mos jenë të lidhur me krimin, që

kanë prioritet ekonominë e qytetarëve të zakonshëm dhe jo pastrimin e parave të pista të drogës dhe korrupsionit. Më vonë, në profilin e tij në "Facebook" ai shkroi: "Donika Prella dhe Arta Marku fshehin përgjimet dhe provat e prokurorisë që lidhin Vangjush Dakon dhe Damian Gjokunurin me ban-

dat e krimit të organizuar në pazare korruptive "tenderë dhe para në shkëmbim të votave" nga Dibra në Durrës dhe në Vlorë. Dy vjet pas miratimit të reformës në drejtësi duhet të kishim një prokurori që ndëshkon dhe nuk mbron politikanët e lidhur me krimin", u shpreh Basha.

DEKLARATA

"Qeveria e lidhur me krimin; drejtësia e kapur nga qeveria; ekonomia e kapur nga oligarkët që pastronë paratë e krimit dhe të korrupsionit qeveritar, këto janë sfidat jetike, pa zgjidhjen e tyre Shqipëria shkon drejt katastrofës totale", - u shpreh dje, Lulzim Basha.



Kryeministri Edi Rama në foltoren e parlamentit


ÇLIRIM GJATA

Juristi Çlirim Gjata tha se, nëse ligji për magistratët miratohet të hënën në Kuvend do të jetë antikushtetues. "Kriteret për emërimin e gjyqtarëve caktohen me ligj, jo me dispozita kalimtare. Sot i bie hajde bëjmë një dispozitë kalimtare me certifikatë kur janë kartat e identitetit. Mazhoranca e bëri vetëm reformën në drejtësi, i ka kaluar të gjitha ligjet me arrogancë", - tha Gjata.

Të hënën seanca e fundit e Kuvendit, PS kërkon konsensus nga PD

Votimi për magistratët, Hysi: Opozita të tregojë përgjegjshmëri

Nënkryetaria e Kuvendit, Vasilikë Hysi i bëri thirrje opozitës që të hënën, në seancën e fundit për këtë sesion parlamentar, të votojë për ligjin për magistraturën dhe Kodin Rrugor. Në një prononcim për mediat, Hysi thotë se opozita duhet të tregojë përgjegjshmëri me ligjin për magistratët, duke ndihmuar që gjykatat të mos zhyten më tej në kolaps për shkak të pastrimeve që po bën vetingu. "Vetingu po ecën dhe po ecën shpejt. Brenda korrikut do të kemi rezultate shumë më të mëdha. Nga ana tjetër, kemi një grup studentësh të shkëlqyer që dëshirojnë të fillojnë magistraturën. E dyta, kemi një grup tjetër magistratësh që presin të fillojnë të punësohen. Nëse ne themi që ne nuk duhet të bilokojmë, ta çojmë sistemin në kolaps, ne duhet të kontribuojmë. Ne duhet të jemi



të përgjegjshëm", u shpreh Hysi. "Duke ju bërë apel kolegëve të mi të opozitës për të ardhur dhe për të votuar ndryshimet në ligj për t'u dhënë mundësi në shtator kandidatëve fitues të fillojnë shkollën, dhe nga ana tjetër, ftoj të gjithë studentët që kanë studiuar jashtë, të vijnë dhe të kontribuojnë në Shqipëri", tha më tej, nënkryetaria socialiste e Kuvendit. Hysi tha se "opozita po shkon drejt kërkesës së saj për të ndryshuar dhe zhbërë ndryshimet kushtetuese".

"Me sa kuptoj është bërë pishman që i ka votuar aty ndryshime. Ne kemi mundësinë të gjejmë konsensus për të ndryshuar shumë gjëra në ligj. Unë mendoj që duhet t'i marrim gjërat hap pas hapi. Të mundësojmë një herë fillimin e plotësisht me gjak të ri, me ekspertë, të sistemit të drejtësisë. E dyta, është e rëndësishme të ecim shpejt me vetingu, sepse nga kjo varet Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i cili ka gati dy lista kandidatësh për Gjykatën Kushtetuese dhe duhet të fillojë me plotësimet e tyre. Nëse do të ketë një vullnet politik shumë të mirë e bashkëpunim më të mirë, gjithçka mund të zgjidhet. Nuk ka çështje që vullneti e bashkëpunimi nuk i zgjidh", - deklaroi Hysi.

Deputeti demokrat i përgjigjet thirrjes së Hysit

Bylykbashi: Reforma në drejtësi po kolapson, PS para përgjegjësisë

Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi, në përgjigje të nënkryetares socialiste të Kuvendit, theksoi dje, se reforma në drejtësi po shkon drejt kolapsit. Përmes një reagimi, Bylykbashi, duke iu drejtuar Hysit u shpreh: "21 korrik dy vjet më pas. Vasilikë, t'u deshën kaq vite të kuptoje se reforma juaj në drejtësi po kolapson. T'u deshën kaq vite që të arrish në ato konkluzione që para dy vitesh t'i thamë e stërthamë ne, opozita, në Komisionin e Reformës në Drejtësi". Pas thirrjes së Hysit drejtuar opozitës që të jenë të përgjegjshëm, Bylykbashi u shpreh: "Po Vasilikë, duhet të jesh e përgjegjshme ti dhe kolegët e tu për rrëmujën katastrofale në drejtësi, që ti dhe kolegët e tu gatuar pa dëgjuar paralamërimet dhe kritikatat tona dhe hodhët poshtë me mendjelehtësi poetike propozimet tona, sepse kishit mbështetje ekstranacionale". "Vasilikë, nuk mund t'i kërkojmë opozitës të jetë e përgjegjshme e të votojë që të kompletjë sistemin e kapjes politike të drejtësisë prej jush e të bëhet palë. Meqë nuk ju funksionoi mekanizmi i kapjes afatgjatë tek Magistratura, kërkoni që t'ju ndihmojë opozita? A je e përgjegjshme për këtë kërkesë Vasilikë?!", u shpreh më tej, Bylykbashi. Ai tha se sot, Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s, vend kandidat për në BE që nuk ka Gjykatë Kushtetuese, Gjykatë të Lartë dhe asnjë institucion kushtetues drejtësi, vetëm Shqipëria është. "Përveçse të papërgjegjshëm, ju duhet të viheni para përgjegjësisë, sot dy vjet pasi vratë konsensusin e reformës në drejtësi", - tha Bylykbashi për mazhorancën.

ELBASAN

Kryetari i Partisë Demokratike të Gramshit po hetohet në gjendje të lirë, pasi akuzohet për kundërshtim të forcave të policisë. Elmas Haruni u shoqërua mbrëmjen e së premtes bashkë me Artur Rodhe (sekretar organizativ i PD-së në Gramsh), pasi nuk iu bindën urdhrat të bluve për të dalë nga automjeti, me të cilin ata udhëtonin dhe për t'u shoqëruar në komisariat. Ndërkaq, Policia e Shtetit ka zbardhur dje incidentin me Harunin. Sipas policisë, mjeti ku udhëtonte Haruni është ndaluar për një kontroll në hyrje të Gramshit, por gjatë kontrollit të dokumentacionit, ai ka kundërshtuar dhe ofenduar punonjësit e policisë. Më pas policia ka shoqëruar makinën me gjithë personat që ndodheshin brenda në Komisaratin e Policisë Elbasan, nga ku ka rezultuar se shoferi ishte i dehur. Mësohet se ndaj kreut të PD-së Gramsh ka nisur procedimi në gjendje të lirë për veprën penale: "Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik".

DEKLARATA E POLICISË

Në zbatim të planit të masave nga Policia Rrugore për parandalimin e aksidenteve rrugore, shërbimet e Policisë Rrugore të vendosura në hyrje të qytetit të Gramshit, kanë ndaluar për kontroll mjetin tip "Benz" me targa AA 387 MR, me drejtues shtetasin Artur Rodhe, 39 vjeç, banues në Gramsh, ku në mjet ndodheshin si pasagjerë shtetasit: E.H., 51 vjeç, banues në Gramsh dhe shtetasi E.Z., 35 vjeç, banues në Gramsh. Gjatë kontrollit të dokumentacionit të mjetit, pasagjeri, shtetasi E.H., ka kundërshtuar dhe ofenduar punonjësit e policisë, të cilët ishin duke kryer detyrën. Nga ana e shërbimeve të policisë u bë shoqërimi i mjetit tip "Benz" me targa AA 387 MR me gjithë personat në ambientet e Komisarariatit të Policisë Elbasan. Pas bërjes së testit të alkoolit, drejtuesi i mjetit, Artur Rodhe rezultoi në gjendje të dehur në masën 0.85 mg/l, i cili u arrestua në flagrancë, ndërsa shtetasi E.H., pas përfundimit të veprimeve të kryera nga OPGJ i Prokurorisë u procedua penalisht në gjendje të lirë për veprën penale "Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik". Ndërkohë, "News 24" ka siguruar dje videon e incidentit, e cila tregon

Policia e Shtetit sqaron zyrtarisht incidentin: Ja si ndodhi përplasja

Kërcënoi policët, nis procedimi penal për kreun e PD-së së Gramshit

Elmas Haruni, efektivit: Këlysh i Fatmir Xhafajt, e di çfarë të bëj unë ty, mbaje mend

KËRCËNIMI

"News 24" ka siguruar dje videon e incidentit, e cila tregon se si kreun e PD-së ofendon dhe kërcënon uniformat blu. Gjatë debatit, nuk kanë munguar shprehjet banale dhe paralajmërimet se Elmas Haruni nuk është qytetar i thjeshtë, por kryetar i PD-së në Gramsh. Ndër të tjera në video dëgjohet teksta Haruni i thotë policit: "Mbaje mend. As më ruhen le" të. E di ç'je ti për mua? Një këlysh i Fatmir Xhafajt".



Kreun e PD-së së Gramshit, Elmas Haruni

Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi nxjerr video tjetër: Elmas Haruni u provokua dhe u mor zvarrë



Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi

it të disa sharjeve. E vërteta është krejt ndryshe!" shkruan ai. "Elmasi u provokua deri në kufijtë e së pamundurës, me forca e britma policore të shumta, kur ishte thjeshtë dhe vetëm një pasagjer. Kushdo do kishte

kundërshtuar këtë maskradë politiko-policore. Ishte në rrugën e tij dhe në jetën e tij. U rrethua, u dhunua, u bllokua në makinën e tij e më pas e morën zvarrë, (siç e dëshmon video) pa asnjë shkak nga policia politike dhe reagoi. Manipulimet që serviren me fragmente që i interesojnë policisë, nuk e mbulojnë faktin e përdorimit të saj politik si mashë për të luftuar kundërshtarët politikë me çdo mjet e për të favorizuar Yaristët, kanabistët, trafikantët e kriminelët me e pa kostume rrezëllitse", shkruan Boçi.

gon se si kreun e PD-së ofendon dhe kërcënon uniformat blu. Gjatë debatit, nuk kanë munguar shprehjet banale dhe


paralajmërimet e herëpashërme se Elmas Haruni nuk është qytetar i thjeshtë, por kryetar i PD-së në Gramsh.

Ndër të tjera në video dëgjohet teksta Elmas Haruni i thotë policit:

"Vetë e kruajta b*thën mo!

E di ç'të bëj unë ty. "Mbaje mend. As më ruhen le" të. E di ç'je ti për mua? Një këlysh i Fatmir Xhafajt".

Reagimi i Ballës: Shikoni Lulzim Bashën e Gramshit, PD të kërkojë falje



TRIANË - Kreun e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, ishte i pari nga radhët e PS-së, që reagoi për konfrontimin e ofendimit e kreut të PD-së në Gramsh, Elmas Haruni kundrejt punonjësit të policisë. Me ironi, Balla e quajti Harunin "Lulzim Basha i Gramshit" dhe e akuzoi atë për fjalorin rrugaçor të përdorur. Gjithashtu, ai i kërkoi Partisë Demokratike të kërkojë ndjesë publike për këtë ngjarje.

REAGIMI I PLOTË

Shikoni dhe dëgjoni Lulzim Bashën e Gramshit...

Dje Partia Demokratike reagoi shumë ashpër kundër Policisë së Shtetit për një arrestim "politik" të kryetarit të kësaj partie në Gramsh me emrin Elmas Haruni. Por sot Policia e Shtetit ka sqaruar edhe me pamje incidentin që e bën tërësisht fajtor këtë person. Policia e Shtetit ka sqaruar ngjarjen e ndodhur dje me kreun e Partisë Demokratike të Gramshit Elmas Haruni, i cili nuk iu bind urdhrat të forcave blu, madje dhe i ofendoi ata. Në një deklaratë për median policia bën me dije se mjeti ku udhëtonte Haruni është ndaluar për një kontroll në hyrje të Gramshit, por gjatë kontrollit të dokumentacionit kreun e PD-së ka kundërshtuar dhe ofenduar me një gjuhë rrugaçerore punonjësit e policisë. Më pas policia ka shoqëruar në Komisaratin e Policisë Elbasan makinën me gjithë personat që ndodheshin brenda. Pas këtyre pamjeve, pyetja është a do ta tërheqë PD baltën e mbrëmshme? A duhet zyrtarisht PD të kërkojë ndjesë publike për Lulzim Bashën e Gramshit?



Kërcënoi me armë dy persona, përfundon në pranga 31-vjeçari nga Roskoveci

FIER - Një 31-vjeçar ka përfunduar në pranga e policisë së Fierit, pasi ka kanosur me armë dy persona gjatë një sherri banal. Bëhet fjalë për shtetasin Bushi Hatillari, banues në Roskovec, i cili u arrestua në flagrancë. Sipas burimeve policore, arrestimi i

këtij shtetasi u bë, pasi në vendin e quajtur "Kryqëzimi i Kurjanit", pas një konflikti për motive të dobëta ka kanosur me pistoletë shtetasit: J.T., 27 vjeç, banues në Kurjan dhe D.H., 35 vjeç, banues në Vadhishitë. Në cilësinë e provës materiale u bënë sekuestrimi i armës së

zjarrit tip pistoletë "ZASTAVA" së bashku me krehrin e saj, 6 fishekë pistolette dhe 1 gëzhjojë pistolette. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprat penale: "Kanosja" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit

luftarak". Mësohet se 31-vjeçari ishte emër i njohur për policinë. Disa vite më parë ai është ndaluar me një vajzë nga Vau i Dejës në makinë, por atëherë ka qenë ajo që ka marrë përsipër pronësinë e armës që iu është gjetur.

Kadri Voga: Kërkoj falje për aktin e shëmtuar. Të zbardhet ngjarja, ose vetëgjyqësi

DURRËS

Babai i autorit që dhunoi avokatin Ilija: Im bir u përdor nga një prokuror kriminal

"Me Arian Ndojn kemi konflikt 10-vjeçar, e kam denoncuar për korrupsion tek ambasada e SHBA"

Dhuna ndaj avokatis Ilija Ilija është ngjarje e rëndë. Unë e dënoj ashpër veprimin e djalit tim, Mond Voga, i cili ka kryer këtë akt të shëmtuar. Avokati, familjes dhe të afërmeve të tij si dhe opinionit publik u kërkoj falje në emër të familjes, pasi im bir nuk është i tillë, por është i shtyrë nga një prokuror kriminal e hajdut, Arian Ndoj. Me këtë prokuror jam në gjyqe, ka 10 vjet". Kështu ka deklaruar dje Kadri Voga, babai i njërit prej dy personave, të cilët të enjten dhunuan avokatin e njohur para gjykatës së Durrësit. Në një prononcim për "News 24", i ati i Mondit Vogës që goditi me grusht Ilija Ilian u shpreh se djali i tij është viktimë e prokurorit në fjalë, pasi është nxitur dhe përdorur nga ky i fundit. "Prokurori Arian Ndoj e përdor djalin tim si të fortë, por djali është viktimë e tij, i paguar. Im bir e ka pasur shok shkolle Arian Ndojin. I kam thënë të largohet nga ky person", është shprehur Kadri Voga. Madje babai, Mond Vogës shkon deri aty sa tregon se djali i tij ka dhunuar edhe familjen i shtyrë nga prokurori Ndoj. "Prokurori Arian Ndoj përkrah kriminelët, më ka marrë lokalitë e familjes sime. Ndojin e kam akuzuar për shpërdorim detyre", ka pohuar babai i autorit të dyshuar. Ndërkohë, Voga kërkon nga organet e drejtësisë të zbardhin ngjarjen, ndërsa paralajmëron vetëgjyqësi ndaj prokurorit.

REAGIMI I KADRI VOGËS
"Ngjarja e ndodhur në Durrës ndaj avokatis Ilija Ilija është një ngjarje e rëndë, ngjarje e pazakontë dhe këto veprime për mua janë të dënueshme dhe unë dënoj ashpër veprimin e djalit tim, Mond Voga, i cili ka kryer këtë akt të shëmtuar ndaj avokatis të nderuar Ilija Ilija. Avokatis, familjes së avokatis, të afërmeve të tij si dhe opinionit publik i kërkoj falje në emër të familjes për arsye se djali im nuk ka qenë i tillë dhe nuk është i tillë, por është i shtyrë nga një prokuror kriminal, hajdut, Arian Ndoj, i cili e ka shtyrë djalin tim për të kryer këtë akt të shëmtuar. Me këtë prokuror jam në gjyqe, ka 10 vjet. E kam denoncuar për vjedhje, për korrupsion, për veprime antiligjore, kam bërë kërkesa, letra të gjitha instancave shtetërore deri në ambasadën amerikane për këtë prokuror, por asnjë lloj veprimi nuk është marrë mbi të. Është një prokuror që është gabim në organet e drejtësisë. Është një prokuror që përkrah vetëm kriminelët. Është një prokuror që ka gjetur djalin tim që e përdor për mashë dhe e shtyn në krime, e përdor për të fortë dhe e përdori dhe me këtë



Kadri Voga duke folur për 'News 24'



Mond Voga me prokurorin Arian Ndoj

APELI PËR DREJTËSINË
Kadri Voga dje deklaroi se u bën apel organeve të drejtësisë dhe kryeministrit Rama që kjo çështje të zbardhet sa më shpejt. "Të thellohet hetimi edhe më tej ndaj Arian Ndojit, qoftë edhe ndaj djalit tim që është viktimë e paguar dhe të zbardhet ngjarja. Në rast se nuk zbardhet, unë do të bëj vetëgjyqësi me prokurorin Ndoj", tha babai i të dyshuarit Mond Voga.

"Ka lidhje me bandën që vodhi prokurorinë e rrahën libanezin"

U dhunua para gjykatës së Durrësit, avokati: Dy agresorët i futi prokurori Arian Ndoj



Avokati Ilija Ilija

dola nga seanca gjyqësore, rreth orës 10:30. Më doli para një person dhe më tha: ti je ai që i ke bërë karshillëk prokurorit Arian Ndoj dje (të mërkurën) në seancë gjyqësore, ke bërë të fortin. I thashë

riti deri aty që e mori të gjithë pasurinë, lokalitë që e kishim bërë familjarisht dhe sot ekziston në hipotekë tek familja e Arian Ndojës. Ai e mori këtë duke bashkëpunuar fuqishëm me shokë të tij prokurorë dhe gjyqtarë, të pamoralë, të cilët i blinte me lekë, mua më humbte gjyqin, fitonte Arian Ndoj. Veprimet e kryera edhe

Gjithashtu, avokati sqaroi se një ditë para ngjarjes ka debatuar me prokurorin në fjalë. Në debat e sipër, mësohet se prokurori i ka thënë Ilias: "Do bëhesh pishman për këto që the". "Kur po debatoni me prokurorin Ndoj, i ktheva një përgjigje që unë nuk jam katundar si ti. Ai m'u përgjigj se për këtë fjalë që the sot do pendoheh shumë shpejt. Njëri ka qenë shoqëruar i Arian Ndojit. Banda që ky ka lidhje si prokuror vodhi prokurorinë e Durrësit, ata që rrahën libanezin për tokën. Është po ky grupim që hetohet nga prokuroria e Durrësit", u shpreh për "GSH", avokati Ilija Ilija, i cili ka mbrojtur grupin e Shijakut dhe ka qenë edhe avokat i Lul Berishës.

që kjo çështje të zbardhet deri më një, të thellohet edhe më tej ndaj Arian Ndojit, qoftë edhe ndaj djalit tim që është viktimë e Arian Ndojit, që është i paguar, të zbardhet. Në rast se nuk zbardhet, unë me Arian Ndojin, për veprimin që ka bërë ndaj avokatis Ilija Ilija, që e ka shtyrë çunin tim për ta kryer këtë veprim, do bëj vetëgjyqësi.

Tentojnë të grabisin dhe plagosin të zotin e shtëpisë, 1 në pranga e 1 në kërkim

POGRADEC - Policia e Pogradecit ka arrestuar një 42-vjeçar, pasi në bashkëpunim me një tjetër person kanë tentuar të vjedhin një banesë dhe në përleshje e sipër kanë plagosur lehtë pronarin. Ka qenë një qytetar që ka telefonuar policinë duke njoftuar se dy shtetas po tentonin të vdhnin një banesë. Mësohet se ngjarja ka ndodhur rreth orës 21:00 të mbrëmjes të së premtes, në fshatin Rrëmenj. Sipas burimeve nga policia lokale, në banesën e shtetasit A.D. 37 vjeç, kanë hyrë dy persona për të vjedhur. Menjëherë në vendngjarje shkuan shërbimet e Komisarariatit të Policisë Pogradec, të cilët kapën 42-vjeccarin Erjon Ibi, banues në fshatin Çërravë. Ky shtetas në bashkëpunim me A.H., 40 vjeç, i cili ka mundur të largohet, i kishin hyrë në katin e dytë të banesës dhe pasi janë diktuar nga pronari i saj e kanë hasur në rezistencën e tij, e kanë goditur këtë të fundit me një njet të fortë duke i shkakuar dëmtime të lehta trupore. Të njëjtat burime thanë se Erjon Ibi ka mundur të marrë vetëm disa bizhuteri, të cilat iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Ndërkohë, policia po punon për vënien në pranga të bashkëpunëtorit.

Përfitojnë invalidë, jetimë, viktima të trafikimit e dhunës, prindërit me shumë fëmijë

Bashkia, gati listën me 3200 përfitues të ndihmës ekonomike

Këshilli bashkiak do të miratojë vendimin për pagesat për periudhën 1-31.7.2018

Bashkia e Tiranës do të mbështesë me ndihmë ekonomike rreth 3200 familje në kryeqytet. Bëhet fjalë për pagesën e ndihmës për muajin korrik. Lista i është dorëzuar anëtarëve të këshillit bashkiak dhe pritet të miratohet në mbledhjen e radhës. Në projektvendimin e siguaruar nga "Gazeta Shqiptare" mësohet se, kanë aplikuar për ndihmë ekonomike 2721 familjet, individë me statusin e jetimit 285 persona, me një fond 850000 lekë, individë viktima të trafikimit 5 persona, me një fond 15000 lekë, individë viktima të dhunës në familje 70, me një fond 210000 lekë, individë prindërit të fëmijëve të lindur: atrinjakë 18 familje, me një

fond 162000 lekë; b)katërnjakë 4 familje, me një fond 64000 lekë; c)pesënjakë e më shumë nëjerësh 1 familje, me një fond 25000 lekë. Gjithashtu, pritet të përfitojnë fëmijë në kujdestari të një familje kujdestare 49 aplikime, me një fond 441000 lekë, dhe fëmijë me aftësi të kufizuara në kujdestari 3 aplikime, me një fond 30000 lekë.

APLIKIMI

Administratori, në prani të kryefamiljarit, bashkëshortes apo individëve plotëson online në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike, të cilët përmbledhin informacionin për: demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; llojin e banesës; pasuritë/asetet shtëpiake; të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale. Është me shumë rëndësi që informacioni të jetë i saktë, pasi në rast të kundërt penalizohen familjet për deklarim të rremë.

Lista e familjeve aplikante verifikohet automatikisht nga sistemi elektronik me të gjitha institucionet dhe pasi përfundon ky verifikim në lidhje me saktësinë e informacionit merret vendimi për këto familje.

Table with 6 columns of names and numbers, listing individuals eligible for economic aid. Includes names like Abaz Aqif Kosta, Gezim Ahmet Sina, and many others.

Table with 4 columns and 100 rows of names and numbers, representing a list of individuals and their corresponding identifiers.

Table with 4 columns of names and numbers, listing individuals and their associated numerical values.

E DIEL

22 Korrik

2018



NGA ARISTOTEL MICI

Në veprën e tij monumentale "Historitë" Herodoti na përshkruan mjaftë hollësisht rreth Orakullit të Dodonës dhe banorëve për rreth saj. Historiani më i vjetër i botës aty na njeht edhe me pellazgët, duke i konsideruar ata jo vetëm si më të herëshëm se helenët, po edhe që kanë ndihmuar në formimin e tyre kulturor dhe shpirtëror, krahas ndikimit egjiptian.

Me fjalët e tij Herodoti do të përforcojë idenë se jo të gjitha zakonet Helenët i kanë marrë prej egjiptianëve. "Siç do ta shpjegoj, - shkruan ai, gjithë zakonet helenët nuk i kanë marrë prej egjiptianëve, po prej pellazgëve. Prej pellazgëve kanë marrë edhe gdhendjen e shtatoreve të Hermesit... Më parë, siç kam dëgjuar në Dodonë, - vazhdon të tregojë Herodoti, - pellazgët gjatë të gjitha flijimeve që kryenin u luteshin "perëndive" pa përmendur ndonjë emër, a po epitet të veçantë, sepse nuk kishin dëgjuar ende për gjëra të tilla..... Shumë kohë më pas mësuam emrat e perëndive të ardhura prej Egjiptit - përveç atij të Dionisit, të cilin e mësuam shumë më vonë. Pas një farë kohe u këshilluan me orakullin e Dodonës, që është orakulli më i lashtë i Heladës dhe atëherë ishte i vetmi. Pellazgët e pyetën orakullin nëse duhet t'i praninin këto emra perëndish që u patën ardhur prej barbarëve. Orakulli u tha se duhej t'i praninin. Dhe pikërisht qysh atëherë ata përdornin emrat e perëndive, kur kryenin ritet e tyre. Edhe këto veprime helenët i kanë trashëguar prej pellazgëve."² "Por vetëm dje ose pardje, si të thuash, helenët mësuam pre-

jardhjen e çdo hyjnie. Me që mendoj se Homeri dhe Hesiodi kanë jetuar jo më shumë se katërqind vjet para meje, ishin ata që krijuan një teogoni (pemët e familjes së perëndive) për botën helene, pra

ata u dhanë emra atyre, caktuan nderet për ta dhe fushat që mbulonin dhe na thanë ç'pamje kishin.

Nga këto që zura në gojë më sipër, pjesa e parë e tyre janë pohime të priftëreshave në Dodonë,

kurse e dyta, ajo që i përket Hesiodit dhe Homerit, është mendimi im."³

Është kuptimplot fakti që Herodoti po thaujse në të gjitha rastet, kur pikëtakohen ndërveprime mi-

dis pellazgëve dhe helenëve, të parët, pra pellazgët i konsideron si pararendës të helenëve, gjë që duket edhe në faqet e librit të VII të veprës, në parag. 95, të këtij libri shohim:

→ Vijnë në faqen 14

AKILLI *i falej* Zeusit PELLAZGJIK të DODONËS

(Iliada, XVI, V. 223- 238)

Redaktor: Ben Andoni. Grafika Artan Buca 345

{ Në këtë numër: REXHEP FERRI, BARBARA, KORUN, ARISTOTEL MICI, ARQILE TETA, VAHID HYZOTI ETJ... }

A

ARGUMENT

Në veprën e tij monumentale "Historitë" Herodoti na përshkruan mjaftë hollësisht rreth Orakullit të Dodonës dhe banorëve për rreth saj. Historiani më i vjetër i botës aty na neqj edhe me pellazgët, duke i konsideruar ata jo vetëm si më të herëshëm se helenët, po edhe që kanë ndihmuar në formimin e tyre kulturor dhe shpirtëror, krahas ndikimit egjiptian.

Herodoti për Orakullin e Dodonës Akili i falej Zeusit Pellazgjik të Dodonës

(Iliada, XVI, V. 223- 238)

NGA ARISTOTEL MICI

Vijon nga faqja 13

Është kuptimplot fakti që Herodoti po thuhet në të gjitha rastet, kur pikëtakohen ndërveprime midis pellazgëve dhe helenëve, të parët, pra pellazgët i konsideron si pararendës të helenëve, gjë që duket edhe në faqet e librit të VII të veprës, në parag. 95, të këtij libri shohim:

"Edhe banorët e ishujve të Egjeut kishin prejardhje pellazge, po më vonë u quajtën jonianë për të njëjtën arsye si edhe jonianët e dymbëdhjetë qyteteve, që ishin shpërngulur nga Athina".

Duke lexuar Herodotin, gjithnjë të bije në sy mendimi i tij për t'i quajtur fiset helene si akejti, athinasit, jonianët me origjinë pellazgë siç thotë edhe paragrafi, që pason: "Në kohën kur pellazgët zotëronin atë që tani quhet Heladë, athinasit një popull pellazgë, quheshin **kranaj** (nënvizimi im, AM).

Nga fjalët e cituara dhe të vizuara më sipër, që lexohen në paragrafin 44, Lib. VIII, nuk është e vështirë të dalim me tre deduksione:

1)Së pari, Herodoti na tregon se ajo, që në kohën e tij, quhej Heladë, dikur ka qenë vend i zotëruar nga Pellazgët.

2)Së dyti, "athinasit kanë qenë një popull pellazg"

3)Së treti, "në kohën e zotërimit nga pellazgët, athinasit quheshin **kranajë**."

Siç duket në gjithë veprën e tij, Herodoti ka qenë dhe një dijetar shetitës, që kish gjesdisur shumë vende të botës së vjetër, nga Teba në Dodonë, në Athinë, Lemnos, Pelepones. Dhe kudo që vinte, ai përpigje të gjellinte fakte dhe ngjarje, që i dukeshin interesante për historitë, që kish marrë përsipër të shkruante. Nga moria e ngjarjeve m'u duk me interes të veçjao midis të tjerave edhe rrrëfimin për dy orakujt, atë të Heladës dhe atë të Libisë. "Egjiptianët, shkruan Herodoti, - tregojnë sa vijon: priftërinjtë e Zeusit të Tebës më thanë që dy gra, në fakt priftëresha, ishin rrrëmyer në Tebë prej disa fenikasve. Ata kishin marrë vesh se njera nga gratë ishte shitur në Libi dhe tjetra në Heladë. Sipas tyre këto gra ishin të parat që themeluan dy orakujt në këto dy vende. Kur i pyeta si mund të flisnin me kaq siguri, m'u përgjegjen se kishin bërë një kërkim të kujdesshëm për



Lutja e Akilit

Oi Madhërishti Zeus, Zot e Perëndi i Dodonës Pellazgjike, që jeton lartë dhe mendon për Dodonën me dimëer të egër si edhe për profetët e tu, që marrin jetë nga ti..... Më dëgjo o Zot, ashtu si më parë, kur t'u luta dhe ti më dëgjove, duke më bërë të nderuar që arrita t'i shpartalloja me forcë armiqtë e Akejve. Kështu edhe një herë ma plotëso dhe këtë dëshirë për të cilën po të lutem

këto dy gra. Dhe, megjithëse nuk ia kishin dalë t'i gjenin, kishin zbuluar më pas atë çka po më thoshnin për to.

Kjo është ajo që më thanë priftërinjtë në Tebë, por profeteshat e Orakullit të Dodonës thonë që dy pëllumbesha të zeza fluturonin që nga Teba në Egjipt; njera fluturoi drejt Libisë, tjetra aty në Dodonë, pranë tyre. Kjo e fundit u ul mbi një lis dhe paskej thënë me zë njeriu se aty në Dodonë duhej ngritur një orakull i Zeusit.

Banorët e Dodonës e kuptuan se po dëgjoni një urdhër hyjnor dhe u bindën të bënin ç'u tha pëllumbesha. Priftëreshat thonë se pëllumbesha që shkoi në Libi u tha libianëve të ndërtonin orakullin e Amonit, një orakull tjetër të Zeusit. Kështu thoshin priftëreshat e Dodonës, nga të cilat më e vjetra quhej Promenia, e dyta Timareta dhe më e reja Nikandra. Edhe dodonasit e tjerë që banonin

rreth e rrotull tempullit, pajtoheshin me këtë.

Tani do të them mendimin tim sesa ka ndodhur kjo. Sikur vërtetë fenikasit t'i kishin rrrëmyer priftëreshat dhe t'i kishin shitur njerën në Libi dhe tjetrën në Heladë, kjo e fundit, sipas meje, do t'u ketë qenë shitur tesprotëve (banorë të Çamerisë - shenimi im AM), të cilët e patën cuar në vendin që tani quhet Heladë, vend që në atë kohë quhej **Pelazgjia** (Herodoti, *Historitë*, f.124, Libri II,parag.56).

Kështu, duke lexuar dhe komentuar rreth këtij episodi, që ka të bëjë me zanafillën orakullit të Dodonës, e kemi shumë të qartë të kuptojmë se si Herodoti përkatësinë e orakullit të Dodonës ua jep banorëve të Thesprotisë. Ndër kohë, duke qenë se edhe ky orakull ishte ngritur nga zëri hyjnor i Zeusit, siç cicëroi pëllumbesha, vetëkuptohet vetiu që Zeusi si Hyjni i ka përkritur, po atij vendi, që ka qenë quajtur Pellazgjia. Dhe për ta konfirmuar më shumë këtë ide, le të përmendim edhe fjalët e Homerit në *Iliada*, ku tregohet se: "Akili i falej Zeusit Pellazgjik të Dodonës"(Iliada, XVI-223- 238), duke iu lutur me fjalët: ... **Kuptimi i fjalëve lutëse të Akilit, në një përktim të lirë, pak a shumë do të ishte:** O i Madhërishti Zeus, Zot e Perëndi i Dodonës Pellazgjike, që jeton lartë dhe mendon për Dodonën me dimëer të egër si edhe për profetët e tu, që marrin jetë nga ti..... Më dëgjo o Zot, ashtu si më parë, kur t'u luta

dhe ti më dëgjove, duke më bërë të nderuar që arrita t'i shpartalloja me forcë armiqtë e Akejve. Kështu edhe një herë ma plotëso dhe këtë dëshirë për të cilën po të lutem" Nga kjo lutje e Akilit drejtuar Zeusit Pellazgjik të Dodonës indirekt marrim vesh se krye -heroi i akejve, Akili, i ka pas përkritur botës së lashtë pellazge. Deduksioni i dytë, që njerrim nga lutja e Akilit drejtuar Zeusit është fakti që qytetërimi pellazgjik, qysh gjatë Luftës së Trojës, ka pas qenë dominues që para kësaj lufte, pra



përtej shekullit të XII Para Krishtit. Ndërkaq theksojmë, se në kujtesën dhe në optikën e Herodotit, Pellazgjia datohet historikisht në kohë më e lashtë se Helada, siç edhe u tha më sipër.

Përshtypje të veçantë do t'i ketë pas bërë Herodotit rrrëfimet për priftëreshat, që themeluan orakullin e Zeusit në Tebë dhe atë të orakullit në Dodonë. Ai shkruan për to, duke rrrëfyer se ishin shitur si sklave nga fenikasit, dhe se ato vazhdojnë të punonin për thesprotët. Nuk është e vështirë që tek ky paragraf të dalim me deduksionin tjetër se kemi të bëjmë përsëri me një terren të vazhdimësisë pellazgo-ilire:

Ndërsa punonte si sklave për thesprotët, ajo, priftëresha themeloi një shenjtërore të Zeusit nën hijen e një lisi që rritej aty. S'ka asagjë të jashtëzakonme në këtë që bëri, sepse ajo pat shërbyer në shenjtëroren e Zeusit në Tebë dhe pa tjetër do të mendonte e do të kujtonte Zeusin në këtë vend të ri. (Herodoti - *Historitë*, f. 124- Lib-






Herodoti për zakonet e vjetra

Me fjalët e tij Herodoti do të përforcojë idenë se jo të gjitha zakonet Helenët i kanë marrë prej egjiptianëve. "Siç do ta shpjegoj, - shkruan ai, - gjithë zakonet helenët nuk i kanë marrë prej egjiptianëve, po prej pellazgëve. Prej pellazgëve kanë marrë edhe gdhendjen e shtatoreve të Hermesit... Më parë, siç kam dëgjuar në Dodonë, - vazhdon të tregojë Herodoti, - pellazgët gjatë të gjitha flujmeve që kryenin u luteshin "perëndive" pa përmendur ndonjë emër, a po epitet të veçantë, sepse nuk kishin dëgjuar ende për gjëra të tilla..... Shumë kohë më pas mësuuan emrat e perëndive të ardhura prej Egjiptit-përveç atij të Dionisit, të cilin e mësuuan shumë më vonë.

ri -II- Parag.56)

Pra, siç e lexojmë episodin në vazhdimësi, Herodoti rithekson edhe një herë faktin informuese, se qoftë orakulli i Dodonë, qoftë



faltorja për Zeusin janë lokalizuar në mjedisin e thesprotëve, të cilët kanë qenë dhe janë fise ilire në trojet e tyre.

Nga fjalët e priftëreshës, që ka pas themeluar Orakullin e Dodonës, kuptojmë se periudha, kur do të jetë krijuar kjo faltore, është koha kur ndikimet e kulteve egjiptiane përzheshin me kulturën fenikase. Kjo ide të lind, kur i dëgjon fjalët, që ajo nxjerr nga goja e vet, e cila "u tha njerzëve që motrën e saj e kishin shitur në Libi po ata fenikas, që e kishin shitur edhe atë vetë."

Më pastaj Herodoti dëshiron të japë arsyetimin e tij lidhur me personifikimin e murgeshave si shpendë që flasin. Lidhur me këtë dukuri animizuese ai pohon: "Mendoj që dodonasit i quajtën gratë pëllumbesha, sepse ato ishin të huaja dhe gjuha e tyre dukej si cicërim zogjesh. Ata thonë që pas një farë kohe pëllumbesha foli me zë njeriu, sepse atëherë ajo foli në gjuhë që e kuptuan. Sa kohë që fliste në gjuhë të huaj, atyre u dukej se cicëronte, sepse si mund të flasë një pëllumbeshë me zë njeriu? Kur thoshnin se pëllumbesha ishte e zezë, nënkuptonin që gruaja ishte egjiptiane." Kështu, duke u mbështetur në shumë episode të tilla të veprës së Herodotit, një autor i antikitetit, gjeograf nga Hiosi, i quajtur Skymni, arrin në përfundimin se Pellazgët ishin themeluesit e Orakullit të Dodonës⁸, rrënojat e së cilës gjenden në Theproti, ose në Çamërinë e sotme.

**Massachusetts
15 korrik 2018**

Shënime

- 1-Herodoti, "Historitë", libri-II-Parag.
- 2-Herodoti, Historitë, Libri II, parag. 52
- 3-Herodoti, Historitë, Libri II-paragrafi 53, f.124
- 4-Herodoti, Historitë, VIII-Parag.44, f.472
- 5-Homer, The Iliada of Homer, The University of Chicago Press, 1962, pg. 336
- 6-Herodoti, Historitë, lib. ,parag.56
- 7-Herodoti, Historitë, f.125- Libri II-Paragraf 57
- 8-Skymni, gjeograf i sh. III, para Krishtit, nga Hios i Heladës së lashtë, shikohet librin "Iliret dhe Iliria", f.73

**I
IDE**

Tiranën e vjetër, sot, e përbëjnë dhe ia ruajnë zulmën Kompleksi i Ministrive (që edhe këto u modifikuan pak shëmtuar me shtesat në kohën e socializmit), kuartieri i Universitetit dhe struktura ku gjendet rektorati dhe Albanologjia, me godinën përballë të Akademisë së Arteve të Bukura. Kaq mjafton. Po Teatri? Nuk po e përmendim, pasi duket se godina e teatrit ka marrë udhën për t'u prishur...

Pas teatrit, çfarë do të mbesë nga Tirana e vjetër?!

NGA BEN ANDONI

Pamja e një qyteti është materializimi i vendimeve të qytetarëve të saj. Më saktë, verdikti i pak njerzëve që i përfaqësojnë. Dhe, vendimi i këtyre njerzëve, në shumicë kartonësh e ka shfuqizuar atë të dikurshëm për caktimin e Ansambllit Monument kulture të aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës, zonë që asokohe (lexo viti 2000) sanksiononte mosprekjen me ndërtime të reja të një hapësire që sot me vendimin nr. 325 quhet Zonë e Mbrojtur dhe Zonë Historike. Pikërisht, një vit më parë, në prill të vitit 2017 Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin "Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth", i cili përcaktonte kufijtë për zonën historike të kryeqytetit, njëkohësisht edhe për Zonën e ashtuquajtur të Mbrojtur. Në atë kohë, me tolovinë e lajmit të ne, askush nuk pati përshlyen se çfarë do të thoshte ky vendim. Ata, që duhet të alarmonin të parët, as u ndjenë. Ndërkohë, Tirana u përgatit në heshtje për operacionin e ri, atë që do prodhojë në javët në vazhdim realisht trandje.

Zakonisht, ndërhyrjet në qytete dhe sidomos në pjesët historike bëhen në intervale shekullore ose të paktën shumë dekadike dhe jo si ndodh tek ne, ku çdokush do t'i japë fizionominë e vet qytetit, pa marrë parasysh në mënyrë primare interesat e grupimeve të interesit dhe dobishmërinë e preکشme për qytetarët.

...Tiranën e vjetër, sot, e përbëjnë dhe ia ruajnë zulmën Kompleksi i Ministrive (që edhe këto u modifikuan pak shëmtuar me shtesat në kohën e socializmit), kuartieri i Universitetit dhe struktura ku gjendet rektorati dhe Albanologjia, me Godinën përballë të Akademisë së Arteve të Bukura. Kaq mjafton. Po Teatri? Nuk po e përmendim, pasi duket se godina e teatrit ka marrë udhën për t'u prishur. Kohë më parë, në bazë të një ligji për zonën historike shpëtuat të gjitha ato gjëra, të cilat prekeshin nga qeveritaret e atëhershëm, që nuk po iu pëlqente Tirana. Por, gati i njëjti entourage, që asokohe këmbëngulte për qendrën historike, është bashkuar me lloj-lloj argumentash për ta prishur godinën e teatrit, pasi truallit është shndërruar nën jurisdiksion tjetër. E, me atë që po ndodh nuk kupton



më sesa ka pasur pro-prishjes së teatrit, po aq dhe dyfishin mbase për të mos u prishur.

Kurrë më parë, artistët dhe individët e shumtë të jetës socio-ekonomike-politike nuk kanë qenë kaq të ndarë, por edhe kaq hipokritë para ndjenjave të tyre. Ka pasur njerëz që kërkonin të prishej dikur Piramida, por tashmë e mbrojnë me patos mosprishjen e teatrit (!), si ka shumë njerëz, që dikur bërtisnin dhe ishin pjesë e fushatës të hiqeshin apo jo kangjellat e kryeministrit dhe tani nuk flasin dot një fjalë. E tillë është jeta në Shqipëri. Sot, të përplas përballë pushtetit, por nesër duhet të kesh kujdes sepse është projekcioni yt i vërtetë. Dhe, ky projekcion, në varësi të asaj që ke bërë në kohën e një qeverie, të konsiderohet si kredit personal, kur ndërron pushteti. Jo më kot mes artistësh kanë gëluar jo pak herë dhe akuzat për përkatësitë dhe preferencat. Do jemi sërish në këtë qytet dhe do të shikojmë metamorfozat e tjera, por Tirana vallë, çfarë ka pësuar nga kjo kakofoni zërash dhe larmi interesash. Transformim të madh, por duke i humbur pak nga pak rrënjët e saj...

... Nuk kemi më lagje të tëra, ku shtëpitë me vlera historike janë prishur dhe në një katalog të Ministrisë së Kulturës pak vite më parë, ku u listuan shumë vileta, sot, në terren, mungojnë disa syresh. Po ata, s'ka kush t'i mbrojë më. Ashtu si edhe për objekte me histori dhe ndërtime shumë specifike. Kinema "17 Nëntori" u prish kohë më parë dhe tashmë ajo është përmendur sot, e për fat të keq është thjesht kujtim i së shkuarës. Ashtu si kinema "Republika", që përmendet gjithnjë e më pak. U prishën rezidenca të tëra qeveritare dhe me radhë, por askush nuk u ndje. Nuk po flasim për Pazarin, zhdukja e të cilit u bë vite më parë, ashtu si prishja e pamëshirë e godinës së Bashkisë së Tiranës, që vetë ishte ngrietur mbi hapësirën e një objekti fe-

tar, por edhe shumë nga këto të fundit, që u sakrifikuan për hir të modernizimit të Tiranës...

Në mes të kësaj hullie, Kalaja e Tiranës, struktura që mund ta lidhte të gjithë këtë kompleks (ku si objekt është dhe Teatri), ka qenë vetë pjesë e debateve të panumërta. Edhe atë se kanë falur lehtë. Në rehabilitimin e dikurshëm të rrugës pranë saj gërmimet u bënë me ekskavator duke dëmtuar monumentin. Projekti i financuar nga Këshilli i Evropës, që përfshin disa institucione si Ministrinë e Kulturës, Institutin e Arkeologjisë apo atë të monumenteve, u ideua një platformë xhami, solli vetëm pakënaqësi, por gjithsesi si zgjidh. Asokohe u thanë shumë gjëra për të, u akuzuan shumë persona, u eliminua një projekt që do ta evidentonte atë...Por, sërish asgjë.

Megjithatë, ja ku jemi sot dhe zona e trashëgimisë kulturore në kryeqytet, ku gjendet dhe teatri po modifikohet sërish. Nuk po flasim më për Kalanë dhe ndërtime të shumta pa leje të kryer në të, që për ironi u kryen vetëm pak dhjetëra metra nga Bashkia, po flasim për faktin se ndërshimi i herë pas hershëm i rregullave ka prishur sensin e Tiranës së Vjetër.

... Mu, në këtë vend, dikur mendohej se ishte një stacion i Via Egnatia. Me shumë gjasa ai do të modifikohet, duke i humbur Tiranës dhe një nga shenjat më të hershme të ekzistencës së saj. Ashtu, si kanë humbur struktura të tëra ndërtime, objekte të tëra historike, institucione kulturi etj. Çfarë po i mbet vallë Tiranës së shekullit XXI është një fizionomi pak kitsch, që po e largon qytetin nga shenjat më nostalgjike të saj. A do ta riparojmë dot, kur çdo gjë sot justifikohet me modernizimin?! Meshumë gjasa jo, duke ia shtuar plagët qytetit tonë, që i kemi hequr gjelbërimin dhe ia kemi marrë pak nga pak identitetin, qysh prej dekadash të tëra. Mu për këtë votojmë njerëzit tanë, që japin verdiktet shpesh në kurrizet tona...

E

ESS E

Në formën e zakonshme të përshkrimit të autorit kemi këtë esse të tij, që përcjell në një formë metaforike llojin e patriotizmit tonë kombëtar...

PATRIOTIZMI NA MBYTI

REXHEP FERRI

1.
Kush do të na përfaqësojë si model, si humbje, si vlerë...
Nuk e di.
Kemi shkuar përtej moralit të bashkësisë njerëzore.
Këtë dhunë, si ta quaj ndryshe.
Sot është problem i madh për ta mbrojtur nga njeriu që nuk është duke kuptuar asgjë.
Me ëndrën njerëzore është edhe një arsye më shumë për t'i shqetësuar.
Në fund të fundit: Pse të flas?
Kur dikush tjetër vjen e flet më mirë se unë për qejfin e vet.
Këtë qytetërim askush nuk mund ta peshojë e kuptojë më mirë e as nuk mund t'ia hedhë më mirë.
Sokratini miqtë e kanë bindur se duhet ta pijë helmin.
Më në fund çka me pa?!
Para pasqyrës lakmia na solli gjumin e madh.
Në botën që quhet bota e gabimeve të bukura, Helena ka qenë grua e bukur për Paridin.
Jo për mua që Afërditën e kam parë vetëm një herë.
Besoni.
Dje ditën e kam kaluar vetëm duke menduar.
Çka mund të flet njeriu kur flet shqetësimi e jo mendja?
- Ku është dashi i kurbanit?
- Ky është dashi i kurbanit!
Nuk i duron dokrrat.
Dokrrat që i përdor njeriu...

2.
Për këtë histori pa fillim kujt t'i them se çka po mendoj.
Ka shumë gjëra që nuk i kuptoj.
A mund të besojmë?
E pamundur të besojmë...
Ndoshta është edhe mëkat i madh të heshtim.
Para syve tanë populli e ka humbur autoritetin.
Me sojlitë tanë nuk ka mahi.
Ata nuk dijnë të ndalen as kur gjuan rrëfeja.
As nga qetësia para vdekjes.
Patriotizmi i tyre që na mbyti po na kthen në mesjetë.
Na ka bindur se "Njeriu është kafsha e parë që e ka krijuar mjedisin e vet. Por, ironikisht, ai është kafsha e parë që në këtë mënyrë po e shkatërron veten".

3.
Sa për të vërtetën, ku ta gjejmë të shkretën?
Për ta shpëtuar tani është vonë.
Të gjithë po heshtim dhe të gjithë po presim diçka të humbur.
Para pasqyrës nuk po shohim asgjë më shumë se patriotizmin që na mbyti.
Historia që është nën hijen e frikës, pse nuk flet?
Për të larë mëkatet çdo ditë bëjmë një të keqe.
Fama e saj lexohet si histori e pashkruar.
Pse?
Ku ta di unë pse!



Duke kaluar nga një rrafsh në rrafshin tjetër, të vërtetën gjithmonë e kemi varrosur pa arkivole e pa ceremoni mortore.

4.
Kjo dinakëri as sot nuk është e panjohur.
Koha shtesë gjithmonë na ka sjellë mashtrime.
Nëse ka ndonjë qëllim jeta, tani ia kemi gjetur fillimin.
Për turpin e madh, turpin e madh.
Pse ta ndryshojmë mendjen.
Për asgjë tjetër nuk jemi në vendin e duhur.
Shpejt na humb besimi dhe lidhemi me diçka tjetër.
Prandaj, nuk kemi se kend ta akuzojmë.
Për tu ruajtur nga miku që të lë në baltë e të godet befaz, të gjithëve na kanë dalë brirët.

5.
Të një kufi tjetër, merrni frymë më qetë.
Dhe mendoni më pak se pak më ndryshe.
Mund ta hani kot.
Pra, kujdes!
Të pafajshmit, të mërziutit si shpërblim i pret kokrra e kripës dhe leximi i ëndrave.
"Siç ka pohuar shejtani, secili njeri lind si poet, jeton si vjedhës dhe vdes si lugat".
Dhe kreyt në fund: i mbyll sytë pa kuptuar asgjë...
Kur fantazia nuk njih kufi ëndrra geografike është pika e fun-

dit e gabimeve.
Pse, si dhe pse reja i gjuan edhe njerëzit e mirë.
Deri tani për mua nuk ka përgjigje.
Çka thonë të tjerët nuk dua të besoj.
Ende e kam një ëndërr ku mund të pushoj.
Sa e padrejtë është jeta, është pyetje enigmatike.
Shpesh më vjen të mendoj se nuk është ashtu, edhe kur bie fjala se është ashtu, çka mund të bëj unë.
Patriotët sojli janë mësuar të na tregojnë se si duhet të marrim frymë.
Kjo lojë nuk luhet për herë të parë.
Në popull vetëm flitet:
- Ejani, Kaloni! Vetëm kaloni!...
Nga fjalët e vonuara, fjalët e besueshme kurrë nuk arritëm ta kuptojmë se çfarë nëna na ka zënë.
Mendoni çka të doni.
Mori fund edhe një histori pa fillim.
6.
Me gënjeshtër e pa gënjeshtër nga flamuri kombëtar na ikën ngjyra e kuqe e ngjyra e zezë.
Çka t'i themi këngës popullore? Gjergjit?
Shqiponjës?
Ku është Nëna?
Ku është Ajo?
Nëna, Nëna!
- Jam me ty, jam me ty! - i thashë.
Shpirti i saj ndoshta më dëgjon.
- Më fal, e di! - prapë i thashë.

- Jo, ti nuk e di! Kam jetuar nga vuajtja. Për fituesin dhe humbësin nuk po flas.
Njeriu gjithmonë i ka dy mundësi: të bëj keq e më keq ose mirë e më mirë.
Si do të orientohemi nuk e di.
Më fjalën e parë Zoti nuk i ka shkruar të gjitha fatet.
7.
Duke mohuar të tashmen, çka mund të presim.
Evropën e luftërave nuk mund ta kuptojmë.
Tani as për mëkatet e bëra nuk e pyet askush.
Për të fshehur shqetësimin ajo mund ta lëshojë një shikim kah qielli.
Kur flasim për dashurinë ajo ndoshta e harron urrejtjen.
Kur flasim për urrejtjen ajo ndoshta i harron milionerët.
Kur flasim për milionerët ajo ndoshta i harron demonët e shenjtë.
Prandaj nuk mund të na ndihmojë askush.
Në "Farmën e kafshëve" vetëm njeriu e ka varrosur njeriun për së gjalli.
Si e pse jemi të pafajshëm të kuptojmë.
Në Parajsën e zhgënjimit, pazari i ditës dikujt i shkon për sh-tati.
Pas kësaj rrupalle të çmendur, kurrë nuk do të dihet se kush qëndron.
Ideja fitimprurëse s'ka as dëshmitar e as fajtor.

Ka mashtrime dhe ligje të pashkruara.
Ligjet e hekurta vetëm nëse ndryshe nuk janë shkruar nga dora e fortë.
Edhe ky fund e ka një fillim të çmendur.
Njëherë e pyeta veten:
-Sa e dhimbshme është jeta pa atdhe?
Për këtë pyetje të jetës sime deri tani përgjigje nuk ka.

8.
Nga koha e mbetur na erdhi njëfarë dite për të festuar me duartrokitje e pa ligje e me tregtarë flamujsh.
Pasi dolëm nga vetmia bizantine, pse u çmendëm.
Për fat të keq nuk e kuptoj.
Për njeriun që mendon dhjetë herë e flet një here nuk shohim e nuk kuptojmë asgjë më shumë se fatqeqësinë e tij.
Nga Kanuni i Lekës mësova të përdori heshtjen.
Vrasësi me pagesë, me maskë e pa maskë të kthen me fytyrë kah muri dhe qeshet.
Kufiri i pakuptueshëm nuk është aty.
Afër, shumë afër syve të mbyllur na pret fundi.
Në lagjen "Velania", në Prishtinë, në një mur me shkronja të mëdha dikush kishte shkruar: "Hapi sytë o Zot! Sa të mirë jemi!"
Po pak më larg po ashtu me shkronja të mëdha dikush tjetër kishte shkruar:
"Unë votoj, ti voton, ai - ajo voton. Ne votojmë, ju votoni, ata dhe ato përfitojnë".
Si duket kështu fillon gjithmonë.
Për herë të parë nuk kisha frikë.
E pabesueshme për mua që kërkjoja diçka.

9.
Kemi pas folur me e pi një kafe bashkë.
Tani nuk mund të ndryshojmë asgjë.
Ndoshta jemi fundi i fundit.
Nga historia e jetës së përditshme njeriu si qenie e pafrenuar bën krime dhe del pa u lagur.
Më në fund, të gjithë dalin para pasqyrës për ta parë lirinë.
Fati kishte harruar të na shohë.
Ligjet pse i kemi lënë për më vonë? Kënd ta pyes, kënd ta bëj fajtor?
Njerëzit janë maskarenj, të mashtrorë me bamirësi.
Nesër si do të quhet njeriu nuk e di.
Hipnotizimi mund ta kalojë yllberin dhe botën e botës së vogël e fut në xhep.
Dhe heshtë për ta kuptuar heshtjen.
Në fund të ditës.
Në mes të natës.
Ku na presin sfidat për ta mundur kohën?...

P

POEZI

NGA VAID HYZOTI

TI KURRË NUK DO TË JESH E IMJA...

Kurrë nuk do të jesh e imja, ndonëse duhemi aq shumë,
Kurrë nuk do të prek e të frymoj poreve të lëkurës tënde të
brishhtë,
Kurrë s'do t'i pi sytë e tu të thellë,
Kurrë nuk do të të thith gjoksën tënd të fildishtë!
Kurrë s'do të mbytem në humnerën ku shuhet çdo burrë,
Kurrë nuk do krenohem për rënkimin e orgazmave,
Kurrë nuk do të fryjë flokëve kur të fshihem në gushë,
Kurrë nuk do çmendem e të them në vesh fjalët e të mar-
rëve.

Nuk do gëzojmë bashkë, se unë nuk jam i plotë,
Nga vetja dhashë gjithçka dhe mbeta me gjysmë zemre.
Dhe ti më je aq larg në vite e në vende
Më ktheve gati krejt një pako mungese.
Më bëre të besoj se vetëm shpirti duhet,
Veç ende nuk e di në shpirt unë kam akoma...
Prej ëndrrë të krijova, prej shijesh e ndjesish,
Gëzo , se kurrë s'do shihemi. Nuk dashuron kufoma...

KAM MBETUR LARG...

Kam mbetur aq larg prindërve të mi...
Ka mbi njëzet vite që dhe varret s'u kam parë!
I blemë mermerin më të shtrenjtë
Dhe prapë (më thonë),
Ka plasa në damarë...
Kur do përmbyssem, në një përqafim,
Të nxjerr një lot,
Të shërohem duke qarë...

Kam mbetur larg,
Sa lojë e ndyrë jeta!
Fëmijë u ikja nga duart,
Para tyre vrapoja unë...
Prapë para meje ata ikën kaq herët.
Shpesh fajtor ndihem:
Mos u vonova shumë?

NUK I NJOH GJARPËRINJTË...

Nuk i njoh gjarpërinjtë që falin helmin për mua,
Helmin që më duhet për ilaçet e zemrës...
Nuk ua njoh pyllin, vendin dhe fshatin,
Nuk e di ku flenë:
Rrëzë gurëve a majë pemës...
Nuk di a ushqehen me kafshë të egra,
Nuk di a gjuajnë për minj apo hardhuca,
Mbase ne bahçen me barë të dendur,

Ku ka shtëpinë
Ajo sygjarpërueshja...
Nuk di sa vazhdojnë të më bëjnë dhuratë
Helmin që më duhet të qëndroj në jetë.
Mbase deri kur helmi të kthehet në mjalte,
Deri kur sygjarpërueshja
Të më mëkojë vetë...

LUMI

Një lumë ka lënë shtratin bosh në vendlindje,
As gjeologët, sizmologët nuk e dijnë pse...
Një lumë që thyen malet, që gjërren fëmijërinë time,
Vetëm emrin ka lënë atje...

Pata lëshuar britmën e mallit,
Dhe maleve ku rrjedh iu krijuan të çara,
Dhe pemët pa mua në buzë të lumit,
Janë pa gjethe, krejt të thara...

Një lumë që unë e thirra të lëvizte në vena e kapilarë,
Ka gjetur poshtë deteve dhe oqeanit një udhë të fshehtë,
Të më bëhet kompresë kur digjem në ethe,
Të më mbajë në jetë...e lëvizte në deje, të mbajë

Në jetë!

U RRËZUA NJË GRUA

...dhe taka u thye, ajo ndrydhi këmbën
Dhe unë u tremba nga një "ah" i lehtë!
Ndofta një kallo sa një kokërr orizi,

Romantizmi i kohës sonë i përcjellë në një mënyrë pak të thjeshtë nga autori...



I theri në këmbë,
E bëri të zbehtë!

E bëri të zbehtë, i dha pak dhimbje,
E bëri të bukur, si hënë vjeshte,
Të ruante dritën, ndërsa po binte,
Denjësisht mbahej
Tek një buzëqeshje!

Urreva në çast kryetarin e bashkisë,
Përse me gropa ishin kthyer rrugët,
Dhe desha që drejtuesi i kompanisë së asfaltit,
Pa një, pa dy...
Në burg të futet.

Por gruaja u mbajt me një përqafim,
Aq ëmbël, "padashje" më shtrëngoi mua...
Dhe shpalla njëherësh unë amnistinë,
I fala , se bukuria
Tek unë u rrëzua!

FLI

Duhet të flesh, më mirë se të heshtësh,
Të presësh një fjalë, një shenjë nga unë...
Ti je një xhind,
E çmendur ti je,
Sa shumë më flet,
Kur më vë në gjumë!

EPITAF

Asgjë s'kam qenë,
Asgjë s'do jem...
Në jetë më sollën
Të pi pak helm...

VAJZA E ËNDRRËS

U shfaq vajza e ëndrrës së një jete,
Ajo që jeton pas malit të syve të natës sime.
Tani kam frikë se do vijë të më takojë,
Tani kam frikë se kurrë
S'do përkundem në ëndërrime.

E kam krijuar vetë dhe është aq e rrallë,
Kudo e kam veshur me petale...
Firmat famoze të modës rrinë kryeulura,
Mijëra punëtorë do të dalin
Në rrugën e madhe...

Asnjë sallon bukurie nuk merr përsipër
Të modelojë flokun e saj aq të rëndë...
Flokët që e ruajnë aq shumë mendjen,
Që zemrës i merr
Fjalën e pathënë...

Më sheh në sy dhe unë zë frikësohem,
Rrezja e vështirimit tej e tej i shkollon malit.

Ah po të vinte, eh ç'dasëm do të bënim,
Me lot, me lule për mua dhëndrrin
Në...shtëpinë e funeralit!

KE MBYLLUR DERËN

Ke mbyllur derën nga brenda dhe ke humbur çelësin,
Të mos dalë asnjë ofshamë nga dhimbja përtej mureve.
Ai që doli e përplasi fort dhe të fyti,
Të tjerët trokasin
Dhe të ftojnë me lutje...

Dhe ti troket fort dhe ke dëshirë të dalësh,
Por askush nuk dëgjon përpëllitjet e shpirtit,
Askush nuk të sheh zbukuruar petalesh,
Trokasin, jo për ndjenjë,
Veç për shijen e ... mishit!

Ndaj rri derëmbyllur nga brenda e nga jashtë,
Ndaj s'do t'i përgjigjesh asnjë trokitjeje...
Në shpirt ti vazhdon të jesh një vajzë,
Që do një përkëdhelje
Para rendjes për rritje...

MBAJ SYTË HAPUR

Mbaj sytë hapur e çdo ditë njoh më shumë njerëz,
Eci syhapur dhe shkel e njoh sa më shumë vende.
Bota vjen e më zvogëlohet dhe viset s'më ngjallin më magji,
Picërroj sytë dhe hapin s'e ngas në rendje.
Nuk është se u plaka, nuk më lë shikimi as dëshira,
Por shpesh dua të iki larg kësaj bote.
Ankohen sytë, se njerëzit kthehen në gjilpëra,
Të qepur me sy vetëm në portofole!

ËSHTË SHPIKUR
NJË MAKINË E RE

Një makinë e re është shpikur, që ka trurin tim,
Si unë udhëton pa sy, përmendësh e di rrugën...
Nuk shkel kurrë vijëzimet, s'ka mushkëri për borinë,
Para dritës së kuqe i këputen gjunjët.
Një makinë e re, që bindet aq shpejt,
Me një pëshpërimë vihet në lëvizje.
Si unë që zgjohem e rend në punë,
Si unë që ngaj një orë me kurdisje;
Si unë, që nuk më duhen tabelat,
Se rrugën për punë e mas me hapa.
Për estetikë ka xhama, si sytë që kam në ballë,
Se kurrë nuk shoh as anash, as prapa.
Një bateri të vogël - në bagazhin e zbrazur,
Aq sa çanta ime e bukës me vete...
As dimër, as verë nuk i hap xhamat,
Si uniforma e punës në veshje.
Një makinë pa shofer është sot në modë,
Që bindet pa të bërtitur, me një urdhër të lehtë...
Një makinë që më ngjan mua e shumëkujt në botë,
Se makina si ne njerëzit duhet të jetë!

P

POEZIA

Në këtë numër po sjellim një autore të njohur sllovene, e cila ka kontribuar shumë në përkthimin e letërsisë së huaj në vendin e saj...

NGA BARBARA KORUN

Kalkuta, në fund të mijëvjeçarit të dytë

Një tjetër Krisht trokiti në derë.
Nuk ka këmbë. Me siguri ia kanë prerë prindërit,
kështu mund të lypë më lehtë për ta.
Veç një plagë në vend të fytyrës.
Nuk ka më forcë
të shtyjë as karrocën e tij prej druri.

Krishti tjetër po të pret para portës.
Nxito, që të mos e shkelë turma e njerëzve
që i largohet policisë.
Qentë e egërsuar e të uritur mund ta kafshojnë.
Rend! Ai e di që do të vdesë.
Prandaj trokiti në portën tënde.

Ti nuk e di nëse është Krishti i vërtetë?
Orët e pakta të gjumit i kalon zgjuar
nga frika:
"A ekziston Zoti?" Përmes plasaritjeve të derës
drita e zbehtë hyn në dhomën tënde:
"Zot nuk ka. Bota është e braktisur. I pafe."

Krishti po të pret përpara portës.
Hije të bardha e përshkajnë
kopshtin e errët. Do ta mbash në krahë
trupin e tij të papeshë, vështrimi i tij tek ty,
i pari dhe i fundit.
Atëherë do e kuptosh:
është yt bir.

Shko tani.

GRUA PA EMËR, GRUAJA e NOAH-S
pas përmbytjes

Me muaj, me vite jam fshehur këtu duke pritur.
Pa keqardhje zbrita mes rënkimeve dhe ulërimave
të kafshëve. Është errët, lagështirë, mbytëse. Duhmë e qel-
bur
e padurueshme. Krokodilët hapin nofullën e gjatë plot dhëm-
bë,
Gjarpërinjtë fërshellejnë, luanët hungërojnë nga uria,
mbi të gjitha vulën ia vënë elefantët në kafaze.

Në fillim, dridhesha nga errësira dhe zhurma,
dhe zvarritjet e pakuqutueshme të krijesave të panjohura,
me parandjenjen se ishin - merimanga, minj, shumëkëm-
bështa, akrepa.
Të mëdhenj e të vegjël, të gjithë lëvizin në formacione
të frikshme si uji i padukshëm, i errët
dhe i paprekshëm. U bëra njësh me ta, duke ndjerë
krejtësisht qenien tonë - të ngrohtë, të lagur, të mbytur.

Për 40 ditë e 40 vjet. U plakëm, vënë poshtë
prej pikëllimit dhe urisë sonë. Këtu poshtë nuk ka Zot.
Përmes mjegullës, presim të na shfaqet fytyra me mjekër
e dikujt që do përmbushë fjalën e Perëndisë.

Dëgjo zhurmë: Noa i lëshon kafshët sërish në tokë.
Mbështes fytyrën të një e çarë në derë
dhe drita derdhet e gjitha mbi mua, dritë që e kisha harru-
ar tashmë..

Kur burri im që më kish harruar krejt, do hapë derën,
mbi gjoksin e tij mbushur me erë dhe diell
një tuftë kafshësh do të nxitojnë -
një trup me shumë bishta, me mijëra sy që shkëlqejnë
ecin drejt çdo të papriture. E para - unë.

Hannah Arendt raporton
në gjyqin kundër Eichmann

Jeruzalem, Izrael, Maj 1962

Poezia nuk mjafton,
Mijëra faqe raportesh.
Çdo fjalë ka përpara një emër.

Cila është Barbara Korun

Barbara Korun është poete dhe kritike letrare e nderuar në Slloveni dhe në Europën Qendrore. Ajo është një nga figurat kryesore të gjeneratës së poetëve të rinj radikalë në Slloveni. Ka studiuar gjuhë sllovene si dhe letërsi krahasuese në Universitetin e Lubjanës dhe ka punuar si pedagogje dhe dramaturge. Barbara Korun ka shërbyer si sekretare e PEN Qendrës së Sllovenisë, ka qenë anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve të Sllovenisë si dhe ka dhënë ndihmesën e saj në redaksitë e revistave të njohura letrare "Nova Revija" dhe "Apokalipsa", duke shkruar artikuj, komente letrare, ese kritike dhe poezi. Poezia e Barbara Korun është përkthyer në njëzet gjuhë dhe është botuar në më shumë se 50 antologji anembanë Europës dhe SHBA. Libri i saj me poezi "Ostrina Miline", 1999 fitoi çmimin e Panairit Kombëtar të Librit si vëllimi më i mirë debutues në poezi, çmim ky që jepet çdo vit në Slloveni. Ajo është gruaja e parë që e ka marrë atë çmim. Libri i saj "Pridem takoj", 2011 mori dy vlerësime sllovene: çmimi "Zlata Ptica" për arrihtë të jashtëzakonshme në letërsi dhe çmim "Veronika" për librin më të mirë të poezisë së

viti.

Ajo u zgjodh për të përfaqësuar poezinë sllovene ndër 27 poetët më të mëdhenj europianë, si pjesë e projektit "RUHR-Kryeqyteti Evropian i Kulturës 2010", ku mes autorëve ishin edhe fituesit e çmimit Nobel, si Seamus Heaney dhe Wislawa Szymborska. Së bashku me kompozitorin dhe perkusionistin e jazz-it Zlatko Kaučič, ajo regjistroi një CD me titullin "Vibrato Tištine", 2006, me poezi të poetit avant-gardist slloven Srečko Kosovel.

Nga viti 2008 deri në vitin 2016 Barbara Korun botoi edhe dhjetë libra të tjerë me poezi në gjuhë angleze, kroate, bashnjake, çeke, italiane etj. Barbara Korun bashkëpunon me poetë nga vende të ndryshme në përkthimin e poezisë së tyre në gjuhën sllovene, së pari në Festivalin ndërkombëtar të Letërsisë Vilenica dhe më pas si të ftuar në punëtorinë e përkthimit "Varka e Artë" në Slloveni. Kohët e fundit ajo ka punuar si këshilltare e gjuhës pranë Teatrit Kombëtar slloven, ku jep ndihmesën në përdorimin e gjuhës sllovene për veprat skenike si dhe përkthen artikuj për botimet e teatrit. Barbara Korun është shkrimtare në profesion të lirë.



Nënë Tereza, murgeshë rishtaresh

Çdo emër është një qenie njerëzore: trup e shpirt.
Gjithkush mban përgjegjësi
për ç'tha e ç'bëri.
Jo para Zotit, por para njerëzve.
Përpara gjykatësve.

Këtu s'ka vend për poezinë.
Ka rregulla dhe rregullore, artikull
pas artikulli. Ligj, kushtetutë,
rezolutë, amendamente.
Përpjekje e dëshpëruar - e vetmja që vlen -
për të dalluar të keqen, për t'i vënë një emër
për të lidhur emrin me personin, për ta çuar personin në
gjyq.
Duke ndjekur me durim çdo gërmë
pa e humbur kuptimin nga sytë.
Duke harruar vuajtjen tënde.
Duke i vënë kufij të keqes. Asgjë tjetër.

Jo, poezia nuk mjafton
Por vetëm ajo është burimi i dritës
që mund të ta bëjë ta shohësh të keqen.
Falë saktësisë së saj
arrihtë të dalloj shtresat e realitetit vetjak
dhe shoqëror.
Duke ndjekur shfaqjen e paimagjinueshme,
raportin midis shkakut dhe pasojës.

Të gjitha sistemet e mia të drejtësisë u përmbysën.
M'u shkatërrua gjuha,
përpiqem ta rindërtoj,
me durim, kujdes,
faqe pas faqeje.
Edhe pa gjuhën
mund t'i ruaj ndjesitë
Kjo shenjë në gjuhë më shërben,
dëshmon vëmendje.

Teksa shkruaj,
më pëshpërit të kundërtën,
absurditete pakuqutim,
lojëra të shfrenuara fjalësh e fatesh,
të gjithë loje e gjëra të pamundura;
me një fuqi të egër, të pandalshme
po ma shqyejnë të vërtetën nga duart
dhe po ma kthejnë sërish, por të ndryshuar:
me një hije, të pamasë
e përpëlitëse,
që gërrave u jep formë,
dhe veprimeve kuptimin.

Një natë të errët vere

Një natë të errët vere
zbrita në kopsht

të këpusja një trëndafil për ty -

m'i përplasi gëthet në fytyrë,
më shtyu me kokëfortësi,
duke më shpuar me gjemba.

Tani, në cep të shtëpisë
pres të vish,
ulur aty

dhe ndiej
si dridhet trëndafil
në dorën time,
si shpërthen në errërsirë
gjaku i tij i ngrohtë
dhe i zi.

Gjuha

to Christian Bobin

Gjuha - lumë, pellg nën hijen e bredhit.
Shtrihem në fund, në rërë,
uji më shkon përmbi. E shikoj, shoh përmes tij
në diell dhe në hije.
Më freskon, qetësia dhe trishtimi i tij
Ashtu si uji, gjuha të freskon
Trupi, siç thotë dhe Bobin, bën dritë,
shpirti digjet derisa bëhet i padukshëm -
kështu. Kjo më lë pa frymë,
është kaq e madhe, kaq shumë...
Kujdesem, thith, përziej ëmbëlsinë
në trupin e shpirtit.
M'i tërheq flokët,
fytyrën, gjinj të mi, derdhet butësisht
në ijët e mia, si një dorë e madhe
gjuha - fjalë, ritëm, rrahje zemre.

Pasqyra

Burri shtrihet mbi mua
si mbi ujë.
Në pasqyrën time të lëngët
dëshiron të shohë fytyrën e tij.
Veç uji im është i errët,
i errët e i thellë,
dhe nuk ia kthen pasqyrimin.
Ai kërkon, i shtangur
e më pas i çuditur,
dhe druaj se do të
hidhet në të, mbi mua
për të parë fytyrën e tij atje,
të vdekur.

Përktheu Silvana Leka

Opinioni *i* Ditës

Prapaskenat e një komploti të parandaluar terrorist

Nga Ken Blackwell

(vijon nga faqja 1)

...të Rezistencës së Iranit (NCRI). Duke marrë parasysh që **Assadollah Assadi**, shefi i stacionit të inteligjencës në ambasadën iraniane në Vjenë, u arrestua së bashku me dy mbajtësit e bombës, është plotësisht e qartë se komploti është organizuar në Teheran. Ndërsa Teherani është përpjekur ta përshkruajë komplotin e parandaluar si një operacion "alarmi të rremë" nga opozita, ky pretendim është refuzuar si qesharak nga një zyrtar i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit. Në fakt, inteligjenca e opozitës, e cila operon brenda Republikës Islamike ka zbuluar se vendimi për të ndërmarrë një sulm mbi tubimin ishte marrë muaj më parë nga autoritetet më të larta iraniane, duke përfshirë edhe Udhëheqësin Suprem Ali Khamenei dhe Presidentin Hassan Rouhani.

Komploti i parandaluar ishte ndërmarrja më e rëndësishme terroriste e Iranit në vitet e fundit, por jo e vetmja. Në mars, një komplot tjetër u parandalua në Shqipëri, ku ka një prani të madhe të **Organizatës Muxhahedine të Popullit të Iranit (PMOI/MEK)**, grupi kryesor i opozitës iraniane dhe përbërësi kryesor i koalicionit NCRI.

Sulmet terroriste nga operativët iraniane dhe proksit e tyre datojnë që nga vitet 1980 dhe 1990. Sjellja e Teheranit nuk ka ndryshuar në ndonjë mënyrë domethënëse gjatë viteve. Gjatë dy viteve të fundit, ka patur raporte të shumta të ndalimit nga ana e autoriteteve gjermane të përpjekjeve të Forcës Quds të Trupave të Gardës Revolucionare Iraniane për të spiunuar individë dhe grupe të lidhur me Izraelin si dhe aktivistë të MEK.

Zbulimi i kompleteve në Shqipëri dhe Francë, që ndodhën vetëm tre muaj larg njëri-tjetrit, jep prova të forta se Irani po i shton operacionet e tij në Europë. Kjo nuk është e çuditshme po të merren parasysh kushtet e brendshme të Republikës Islamike, veçanërisht po të konsiderohet se të dy komplotet kishin në shënjestër NCRI dhe MEK. Sulmi në Paris do të kishte shpërthyer 500 gramë eksplozivë TATP brenda një turme me rreth 100,000 njerëz dhe në praninë e qindra personaliteteve europiane dhe amerikane. Planifikimi i këtij sulmi filloi shumë shpejt pasi Irani përjetoi një kryengritje masive që e kapi në befasi regjimin klerikal me thirrje të qarta për ndryshim regjimi.

Lëvizjes protestuese iu dha një tjetër shtysë në mars kur **Presidentja e zgjedhur e NCRI Marvam Rajavi** shënoi ditën e Vitit të Ri Iranian, Nowruz-in, duke lavdëruar kryengritjen mbarëkombëtare dhe duke i nxitur aktivistët prodemokracisë që ta kthejnë vitin që



vjen në një "vit plot me kryengritje." Kjo deklaratë erdhi rreth së njëjtës kohë kur autoritetet shqiptare arrestuan terroristët që operonin në emër të Republikës Islamike. Protestat kanë vazhduar në forma dhe mënyra të ndryshme gjatë vitit 2018.

Autoritetet e regjimit, përfshirë Liderin Suprem Khamenei, e kanë pranuar rolin kryesor të MEK që kur kanë filluar protestat. Këto deklarata nuk lënë asnjë mëdyshje mbi dëshpërimin e Teheranit për të prishur lëvizjen prodemokracisë brenda dhe jashtë vendit.

Për ta arritur këtë qëllim, regjimi është i gatshëm madje edhe të zgjojë qeliza të fjetura dhe të rrezikojë diplomatët e tij kryesorë. Komploti i parandaluar në Francë

erdhi në një kohë kur Teherani po përpikte të bindte europianët të qëndronin në marrëveshjen bërthamore si një përpjekje e fundit për të parandaluar kolapsin e ekonomisë iraniane nga sanksionet e reja amerikane. Kjo gjë ilustron qartë paranojën e ajatollahëve nga lëvizja e znj. Rajavi si një alternativë e mundshme dhe demokratike ndaj regjimit në Teheran.

Sjellja armiqësore e Iranit në Europë e bën qartësisht të vlefshme përqasjen e ashpër të Amerikës ndaj politikës së Iranit. Sekretari amerikan i Shtetit **Mike Pompeo** ishte shumë i saktë javën e shkuar kur akuzoi Iranin se përdor ambasadat e tij për të organizuar sulme terroriste në Europë.

Është e sigurt se NCRI dhe grupet e tij përbërëse do të shënjestrohen në tokën europiane pjestëri në

të ardhmen. Kjo nuk do të ndodhë vetëm nëse qeveritë europiane do ta thyejnë heshtjen e tyre dhe do të ndërmarrin masa serioze për të përçarë rrjetet shumë-vjeçare terroriste që operojnë nën mbulim diplomatik në Austri, Gjermani, Francë, dhe ndoshta në të gjithë Bashkimin Europian.

Përballë këtij kërcënimi, shtetet anëtare të BE duhet të konsiderojnë seriozisht mbylljen e ambasadave iraniane ose përfshajtjen e diplomatëve që mund të jenë të lidhur me Forcën Quds të IRGC apo me Ministrinë Iraniane të Intelgjencës. Duke diskutuar parandalimin e komplotit të Parisit, një zëdhënës i gjykatës belge pohoi se "praktikisht të gjithë nëpunësit e ambasadave iraniane janë pjesë e Shërbimit Sekret Iranian." Megjithatë figurat politike në Europë bëjnë kujdes të mos thonë gjëra të tilla me zë të lartë. Kjo heshtje duhet të marrë fund, përndryshe kërcënimi do të përkeqësohet për qytetarët europianë si dhe për lëvizjen opozitare demokratike të Iranit.

* **Autori është ish-sekretar i Shtetit në Ohio, është Partner i Lartë për Fuqizimin e Familjes në Këshillin e Kërkimit për Familjen. Ai shërben në Bordin e Drejtorëve të Clubit për Rritje dhe në Unionin Kombëtar të Taksapaguesve.**

HOROSKOPI

DASHI

Emocionet e forta mund të dëmtojnë sistemin tuaj nervor dhe duhet ti kontrolloni. Sot humbjet financiare duken të mundshme, nëse bazohen tek fati e të tjerëve. Do të vini re se të afërmit nuk do t'i kuptojnë nevojat tuaja. Mos e përfshini veten në diçka të papërshtatshme.

DEMI

Fillojeni ditën me një shtërvitje të vogël. Është koha që të filloni të ndiheni mirë me veten dhe bëjeni këtë çdo ditë. Bashkohuni sot me njerëz me përvojë dhe mësoni nga ajo që ata kanë për të thënë. Dëgjoni këshillat e dhëna nga të tjerët, nëse dëshironi të përfitonit sot.

BINJAKET

Duhet ta lini të kaluarën pas, nëse dëshironi të dilni nga dëshpërimi. Shikoni tendencën tuaj për të jetuar çdo ditë në maksimum. Gjendja juaj e keqe do të ndryshojë nga partneri juaj i jetës me disa surpriza të veçanta shumë të këndshme.

GAFORJA

Fuqia dhe vullneti tuaj mund të shpërblehet sot, ndërsa përballeni me një situatë shumë të ndërlikuar. Ju nuk duhet të humbni kontrollin ndërsa merri një vendim shumë emocional. Spekullimet do të jenë të rrezikshme, prandaj të gjitha investimet duhet të bëhen me kujdes të madh.

LUANI

Besimi dhe energjia juaj do të jenë të larta sot. Problemet financiare rënojnë aftësinë tuaj për të menduar në mënyrë konstruktive. Ditë e mirë për të vizituar një avokat për të marrë disa këshilla ligjore. Dikush mund të tregohet i pasjellshëm me ju. Mundohuni të gjeni emocione në jetën tuaj martesore.

VIRGJERESHA

Një ditë e mrekullueshme për ti bërë gjërat që të lëvizin në drejtimin e duhur. Shpenzimet ndërkohë do të rriten. Dikush me të cilin jetoni mund të jetë i zhgënjyer dhe i mërzitur me sjelljen tuaj të rastësishme dhe të paparashikueshme. Sot do të takoni një mik të kujdesshëm dhe mirëkuptues.

PESHORJA

Mos e humbisni energjinë me mendime të pavogëzueshme të pamundura, në vend që ta përdorni atë në një drejtim të duhur. Ju mund ta gjeni veten në një situatë të tërëzueshme, e cila gjithashtu do t'ju sjellë përfitime financiare. Disa bashkëpunëtorë nuk do të pëlojnë mënyrën tuaj të trajtimit të disa çështjeve të rëndësishme.

AKREPI

Sjellja juaj jo me klas do të prishë disi humorin partnerit tuaj. Duhet të kuptoni se mungesa e respektit e dëmton rëndë një marrëdhënie. Mos e teproni gjithashtu me shpenzimet për luksin e shtëpisë. Mos zbuloni informacione personale dhe konfidenciale.

SHIGJETARI

Vështirësi financiare duket se kapërcëhen më lehtë, pasi prindërit tuaj ju japin mbështetje. Planifikimi i ditëve tuaja mund të prishet për shkak të një pune urgjente të partnerit tuaj, por më në fund do të kuptoni se kjo ka ndodhur për diçka të mirë.

BRICJAPI

Humbjet financiare janë të mundshme nëse investoni pa kërkuar këshillat e duhura. Edhe situata e dashurisë duket pak e acaruar, gjë që do të shtojë presionin te ju. Nëse jeni në një lidhje, tregohuni më i butë me partnerin, sepse mund të lëndoheni.

UJORI

Jini të fshehtë sa u përket investimeve edhe për qëllimet tuaja të ardhshme. Miqtë do të jenë më mbështetës nga sa e prisnit. Në punë gjërat duket se janë në favor tuaj. Asgjë nuk është e pamundur për sa kohë që ka një vullnet për ti kapërcyer pengesat.

PESHQIT

Buzëqeshja është antidoti për të gjitha problemet tuaja. Është koha e duhur për të hequr qafe zakone tuaja të këqija. Mos harroni se hekur rritet sa është i nxehtë. Një mik i mirë në punë mund të bëjë vlerat e bezdisshëm sot. Bëni ndryshime që mund të përmirësojnë gjendjen tuaj.

Opinion i Ditës

Heshtja i vret të gjithë...

Nga DENISA DAKA*

(vijon nga faqja 1)

... pranë vendit ku jepet drejtësi, pa asnjë shkak apo për shkakun e vetëm se kishte dalë ndesh me interesa të ngushta të klaneve të caktuara.

Një situatë e rëndë dhe e precedencë goditi jo për të parën herë, gjithë komunitetin tonë.

"Kundërveprova sa munda" deklaroi kolegu ynë para kamerave i fashuar...ndërsa në këtë rast përveç dhimbjes e revoltës së tij, gjithkush lexoi në ato pak sekuenca, pafuqinë e hallkave të këtij zinxhiri të sistemit të drejtësisë, në mbrojtje e shërbim të qytetarëve të këtij vendi dhe në rastet e ushtrimit të detyrës.

Ruajna Zot në ç'vend jetojmë!
Ato grushte atë mesditë, kanë mbi të gjithë ne.

Të gjithë bashkë punojmë në një terren të vështirë e aspak të sigurtë, pa asnjë garanci se dita jonë mund të këputet befasi pa shkak, pasi ky vend prodhon krim e gjeneron dhunë paprerë në përditshmërinë e të gjithëve.

E gjitha ç'ka ndodhi dy ditë më parë pranë tempullit të drejtësisë nuk është thjesht një ngjarje, nuk shpërtheu as në këtë rast as befasi dhe as rastësisht, e gjitha tregon qartë tensionet e brendshme të cilat gjenerojnë dhunë mes të gjithëve në këtë vend.

Kjo është dhe duhet të jetë një kabanë alarmi pasi qytetaria përveç avokatëve e me gjerë, po goditet rëndë çdo ditë.

Dhuna dhe barbaria nuk po kursen askënd në këtë shoqëri, ndërsa ky fenomen po merr çdo ditë jetë njerëzish edhe gjatë kryerjes së detyrës.

Konsideroj të patolerueshëm dhe të pafalshëm shurdhërinë e institucioneve dhe personave të veshur me pushtet gjithashtu, përgjegjës kryesore për parandalimin e ndëshkimit e këtyre akteve të rënda, ç'ka e bëjnë të paprecedent nga çdo pikëpamje dhe këtë rast.



Hesht Prokurorja e Përgjithshme prej kaq ditësh, megjithëse kolegu yt bën një akuzë të drejtëpërdrejtë për përfshirjen në këtë krim të një prokurori që i përket një prokurorie të rëndësishme në vend.

Hesht Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Unioni i Gjyqtareve, ai i Prokurorëve, Presidenti i Republikës, Kryeministri, por dhe organizmat e huaja, të cilat janë vendosur këtu (dashtë Zoti) për të mundësuar një standard të pranueshëm drejtësie e qytetarie në këtë vend.

Të gjithë pothuaj heshtin ndërsa ndërgjegjia qytetare është larg të qenit në standardet e duhura, duke suportuar (pa dashje një terren ku krimi përpëron e mban peng çdo ditë sigurinë e qetësinë e të gjithëve.

Dënoj ashpër dhunën kundër kolegut tonë dhe kërkoi, gjithashtu, nga organet kompetente, procedimin sa më parë të autorëve të kësaj ngjarje.

Strukturat shtetërore përkatëse duhet të reflektojnë siç duhet duke ndërmarrë hapat e duhura sa më parë, në mënyrë që të vendoset një standard i gjithë pranuar, në mbrojtje të jetës dhe sigurisë së avokatëve në ushtrim të detyrës së tyre.

Ky zinxhir heshtje duhet të

thyeret e kjo shoqëri duhet të reagojë medoemos që ne të mund të dalim nga ky qerthull i rrezikshëm.

Është i pajustificueshëm dhe i papranueshëm mosveprimi apo dështimi i institucioneve përgjegjëse në çdo rast.

Është detyrë legjitime e shtetit të mbrojë avokatët, integritetin fizik të tyre, duke i trajtuar këta të fundit me respekt e dinjitet të gjithë bashkë.

Heshtja apo mosveprimi kryesisht, i vret të gjithë...

***ANETARE E KESHILLIT DREJTUES TE DHOMES KOMBETARE TE AVOKATISE**

HOROSKOPI

DASHI

Një udhëtim pune do t'ju kënaqë sot. Do të jetë një ditë plot energji dhe kolegjë do të tregohen shumë mbështetës ndaj jush. Çdo lloj detyre që do t'i caktoni vetes do t'ju sjellë para dhe mundësi për të ardhmen.

DEMI

Do të kaloni një ditë argëtuese dhe plot aktivitete. Do të ndiheni shumë të lumtur sot. Pranoi të gjitha ftesat që ju vijnë nga miqtë, sepse kjo është pikërisht ajo çfarë keni nevojë të bëni sot. Sa i përket jetës familjare, do të kryeni me fëmijët aktivitete të ndryshme sportive.

BINJAKET

Do të jetë dita e duhur për të eksploruar mundësitë për pasuri të paluajtshme. Gjithashtu, është dita perfekte për t'u argëtuar në shtëpi. Mendoni sesi mund të ridentroni shtëpinë për t'u ndjerë sa më komod.

GAFORJA

Sot mund të bëni para me fjalët tuaja. Është një ditë e përshtatshme për të udhëtuar të shkurtra. Sjellja juaj pozitive do t'ju sjellë vetëm të mira, madje edhe në jetën sentimentale.

LUANI

Sot keni mundësi të rrisni financat dhe të eksploroni mundësi të reja pune. Ka gjasa që të kryeni disa blerje të shtrenjta, por bëni kujdes të mos e teproni pasi jo çdo ditë është e njëjtë.

VRIGJERESHA

Sot është dita juaj me fat. Kjo është edhe arsyeja pse ndiheni të lumtur dhe të pamposhtur. Do të jeni shumë bujar ndaj të tjerëve dhe kjo do t'ju kthehet me të njëjten monedhë. Pranoi ftesat që iu vijë pasi mund të krijoni lidhje të reja shumë interesante.

PESHORJA

Sot do të shijoni kënaqësinë e të qenit vetëm. Rëmbëni çdo shans për një moment paqeje në privatësi. Ajo çfarë ju dëshironi është një shans për të rigjeneruar veten dhe për t'u ndjerë sa më të relaksuar.

AKREPI

Do të kaloni një ditë shumë të ngjeshur. Shijoni shoqërinë me njerëz kreativë. Marrëdhëniet shoqërore janë shumë të ngrohta dhe ka gjasa që të dashuroheni me një nga miqtë tuaj. Mund të takoheni edhe me dikë që ka një kulturë ndryshe nga ju. Do të mendoni pozitivisht për të ardhmen.

SHIGJETARI

Është një ditë e përshatshme për t'i bërë përshytyje shelve dhe prindërve, sepse një ju favorizojnë. Do të dukeni shumë të suksesshëm para të tjerëve dhe do ju shohin me admirim. Këtë influencë do ta përdorni edhe për të ndihmuar dikë tjetër.

BRICJAPI

Sot do t'ju jepen shanset për të udhëtuar. Bëni çdo gjë që mundeni për të zgjeruar horizontin. Gjithashtu, do t'ju jepet mundësia për t'u trajnuar dhe për të mësuar gjëra të reja. Ndërkohë, ka gjasa të lindë një romancë me një person që ndryshon shumë nga ju.

UJORI

Bëni kujdes, sepse të tjerët mund të përfitojnë nga të ardhurat tuaja. Sot është dita e duhur për të vendosur sesi të ndash trashëgiminë. Kjo do të jetë tepër e vlefshme për të ardhmen tuaj.

PESHQIT

Marrëdhëniet me partnerin dhe miqtë tuaj të ngushtë do të jenë shumë të mira sot. Është dita e duhur për të rregulluar marrëdhëniet me ndonjë mik që nuk jeni konfliktuar prej kohësh.




AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Fjalëkryqi (1)



- 36. Eshhtë për medaljen e parë
- 37. Eshhtë kujdesi i babait.
- 39.... Maiden që këndojnë.
- 41. Një "bombë" tenistike.
- 42. Fillojnë mykjen
- 43. Janë këngëtarët si Jose Carreras
- 45. Eshhtë këngë e kënduar nga komiku
- 47. Lumë në Francë.
- 48. Piktori i Ura e Narnit.
- 49. Kapen në kujfj

- VERTIKAL
- 1. Në hyrje të ambientit
 - 2. Neeson aktor.
 - 3. Ente Sociale Rumune.
 - 4. Ajo e zezë nënkphton arbitrin.
 - 5. Kufizojnë stacionin.
 - 6. Tremb fëmijët.
 - 7. Jepet për t'u marrë.
 - 8. Qytet japonez.

- HORIZONTAL
- 1. Ferguson trainer.
 - 6. Grand Prix
 - 8. Eshhtë stacion beduinësh.
 - 11. Një artikull jo për vejetarian
 - 12. Kujt i vjen... di të bëjë.
 - 14. Kaçaturian kompozitor
 - 16. Logot pa kujfj
 - 17. Parashtesë për vetë.
 - 19. Aktorja protagoniste e Vertigo.
 - 21. Ndezur në aparaturë.
 - 23. Eshhtë si telefilm.
 - 24. Ai i shtatë është kinemaja.
 - 26. Eshhtë me shumë se kërkësë.
 - 28. Cristiano bomber te Real Madrid.
 - 29. Teket e grave.
 - 31. Në krye të masave.
 - 32. Shkon goja... nga nepsi.
 - 33. Duken të gjata ato të pritjes.
 - 35. Gjysmë batakua.


- 9. Eshhtë pemë
- 10. Janë tallësit.
- 13. Roberto trainer italian.
- 15. Freni këngëtare lirike.
- 18. Gjysmë totale.
- 20. Një si divan.
- 22. Tipare pa zë
- 23. Ulet në dhomën e lartë.
- 25. Moore aktor.
- 27. Qe bomber brazilian.
- 30. Ishte shpërthimi i Little Boy.
- 33. Carolina, e bukura e Belle epoque.
- 34. Mbarojnë fare
- 35. Pullman aktor.
- 37. Eshhtë thëllimi
- 38. Meg aktore.
- 40. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
- 41. Një lidhëz.
- 44. Kaluar në krye.
- 46. Fundi i Turandot.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL
- 1. Mund të hidhet të kiromanti
 - 5. Teket e kafes.
 - 8. D'Istria e Helena Gjistikës
 - 12. Smith filozof.
 - 13. Kuke regjisor
 - 14. Një pjesë e minoritetit.
 - 15. Moduli i Neil Armstrong.
 - 16. Mund të jenë qiljeje.
 - 19. Markë pistolette.
 - 20. Mbyllli fushatat.
 - 21. Eshhtë dorëzim.
 - 22. Eshhtë detar.
 - 23. Fillojë ilustrimet.
 - 24. Eshhtë hon.
 - 25. Diftong në duel
 - 27. Një pjesë e rifillimit.
 - 28. Një që kuron karien.
 - 31. Ngarjherë duhen vënë mbi.
 - 33. E egër dhe e fortë.

- 34. Janë thënie e famshme.
- 35. Janë trupa qëllorë të tillë.
- 37. Inicialet e Stone regjisor
- 38. Memoria në computer
- 40. Në krye të trupave.
- 41. Mund të jenë diskografike.
- 44. Eshhtë e zakonshme për pushime
- 46. Skuadër greke.
- 47. Bel i Maupassant.
- 48. Eshhtë thesar.


- VERTIKAL
- 1. E famshme ajo maqedonase.
 - 2. Një zakon.
 - 3. Bëjnë alarm me ar
 - 4. Inicialet e Mallë regjisor
 - 5. Mund të jetë telefonike
 - 6. Ka dy faqe
 - 7. Mund të jetë një cutter.
 - 9. Në mes të dhomës.
 - 10. Mbahet me bateri.
 - 11. Përfshijnë edhe Haitin.
 - 13. Denis i enëve me presion.
 - 16. Paguhen për shërbime.
 - 17. Janë ufo.
 - 18. Ekstrema në tunel.
 - 21. Një atentator vetëvrasës.
 - 22. Markë cigaresh.
 - 26. Arrihet duke mundur.
 - 28. Jonathan, regjisor i Heshnja e qengjave.
 - 29. Eshhtë aparati me zorrë.
 - 30. Pak servizëm.
 - 31. Kështu e ka syrin vigjilenti.
 - 32. Fatih trainer turk.
 - 34. ... Nostra me mafiozët.
 - 36. Mbyllim punimet.
 - 39. Ai i shenjtë është papa.
 - 42. Kufizojnë në teknik.
 - 43. Fillojnë panikun.
 - 44. Fund tuneli.
 - 45. Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

N E N T O K A C A S C E
 T R U P T A L E N T E S
 O R P A N T E R A T
 K E L K A N D I L E T
 B A K U N I N A D A M
 T A M A R G O C O C A K
 M E E O N A T N D U
 A T T O N I K P I E R
 R I T L I Z E O T T O
 K E V A D E T I E I R
 E L S A P A L N O
 T A T P I R A T E R I A

T I R A N A H R P
 O R A R I B T E A T E R
 R O M A K A B I R B E D I
 T N A B A R I T O N I L
 U I R A M B O I L M
 R A D I P A S A N I Z M I
 A V E R R K A L A N I
 T P A R T I A K I N A T
 L A L A F E M R A H
 P E L I K A N I I T H Y
 M I J A S O N I E
 A P A R A T E P A E R

FJALËKRYQI (1)

Argëtim filozofik

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

			2			9	1		
7			5						
3			8					5	
1									
	6	4		1			2		
5		8	7	6					3
					6	8	1		
			3	8					
2									7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	1	6	2	3	8	5	7	9	
5	3	8	7	4	9	1	6	2	
2	7	9	5	1	6	3	4	8	
6	8	1	3	2	7	9	5	4	
7	9	4	8	5	1	2	3	6	
3	5	2	9	6	4	7	8	1	
9	6	3	4	7	2	8	1	5	
1	2	5	6	8	3	4	9	7	
8	4	7	1	9	5	6	2	3	

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	9	3	11	5	9	6	11	1	4	3	R	A	S	T	E	T	P	A	P		
12	16	15	17	6	11	15	4	12	2	12	U	R	A	T	U	R	H	P	A		
6	1	4	12	6	11	5	18	11	2	9	S	A	M	M	M	A	R	A	I	S	
17	18	5	4	12	6	1	4	14	2	3	I	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T
2	1	7	3	2	9	7	9	2	3		P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E
14	4	1	7	9	4	3	7	9	2	3	G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	U
18	4	6	9	8	4	12	7	9	9		B	E	T	O	N	E	K	A	B	O	R
9	2	12	2	4	12	3	9	2	18		S	A	L	I	R	A	M	A			
4	8	2	3	8	6	6	6	16	15		T	O	N	T	I	T	U	L	L	I	
5	12	3	11	2	5	3	6	12			A	R	E	S	A	O					
15	1	2	3	4	5	2	11	2			P	J	A	R	Z	O	T	I	M	I	
17	9	9	15	16	4	4	9	3	2	3	A	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S

Argëtim filozofik

- Mërzitja është një humbje kohe ... asgjë nuk ndryshon, me përjashtim ngatërimit e mendimeve dhe vjedhjen e lumturisë tuaj !!

- Gjithkush dëshiron të shkojë në paradisë, por askush nuk dëshiron të vdesë.

- Fjalët i zgjedhin ata që shkruajnë. Kuptimin, ata që lexojnë.

- Kur bëni një zgjedhje, mos mendoni nëse kjo është e drejtë apo e gabuar ... Mendo të jetë vetëm ajo që me të vërtetë i dëshiron !!

- Njerëzit gjejnë kohë për ata që duan të gjejnë. Njerëzit u shkruajnë dhe u përgjigjen atyre që duan tu flasin. Mos i besoni kurrë dikujt që thotë se ka qënë tepër i zënë. Nëse do të dëshironin të ishin aty me ty , do të ishin patjetër !!
- Mos lejoni të djeshmen të shpenzojë kaq shumë nga e sotmja.
- - Më mirë të heshtësh për njëqind gjëra që duhet të flasësh, se sa të flasësh për një gjë që duhet të heshtësh.
- - Kushdo që nuk mund të kuptojë heshtjen tuaj, nuk mund të kuptojë as fjalët tuaja.

Thënie të mençura

